

UNIVERSITETI PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I EDUKIMIT

STUDIME POSTDPLOMIKE – MASTER

PROGRAMI PEDAGOGJI – TEORIKO SHKENCOR



Ndikimi i ambientit familjar në formimin e personalitetit të fëmijës

Mentori:

Prof. Dr. Januz Dervodeli

Kandidati/ja

Mirlinda Krasniqi

Prishtinë, 2021

ABSTRAKTI

Personalitete të ndryshme individësh përbëjnë shoqëritë, pjesë e të cilave jemi të gjithë ne me llojin e veçantë të personalitetit tonë. Formimi si personalitet bazën themelore e ka në trashëgiminë gjenetike, biologjinë e vet, pra natyrën e lindur dhe më pas atë të fituar nga ambienti familjar, social ekonomik, vendi ku jeton, klima, regjioni etj. Për të edukuar dhe rritur një fëmijë me personalitet të shëndoshë nuk mund të lëmë anash asnjë nga të gjithë elementet, faktorët me ndikim gjatë formimit. Si fillim roli i familjes dhe baza gjenetike janë më të pamohueshmit në këtë drejtim. Sa më shumë dhe më mirë të njohim ecurinë fillestare të formimit të fëmijës, më e lehtë dhe më e suksesshme është rruga drejt edukimit e formimit të shëndoshë.

Zhvillimi, formimi i personalitetit është çështje e ndjeshme në studimet psikologjike, sociale, pedagogjike e shumë disiplina tjera. Procesi i formimit është i rëndësishëm dhe i komplikuar, çdo element përbërës i shoqërisë dhe natyrës ka një ndikim të veçantë gjatë këtij procesi të vazhdueshëm, (duke marrë parasysh që edhe në personalitetin e formuar tashmë ndikohet nga faktorët e jashtëm), prandaj fëmijëria e hershme është periudhë e ndjeshme ku duhet kushtuar tejet vëmendje si baza më fuqishme e ndërtimit, formimit të personalitetit.

Fjalët kyçe: Familje, Fëmijë, personalitet, ndikim, proces, shoqëri.

ABSTRACT

Different personalities of individuals make up societies, part of which we are all with the particular type of our personality. The formation as a personality has the basic basis in the genetic heritage, its biology, ie the nature born and then the one acquired from the family environment, socio-economic, place where he lives, climate, region, etc. To educate and raise a child with a healthy personality we can not neglect any of the elements, influential factors during formation. For a start, the role of the family and the genetic basis are the most undeniable in this regard. The more and better we know the initial progress of the formation of the child, the easier and more successful is the path to education and sound formation.

Development, personality formation is a sensitive issue in psychological, social, pedagogical studies and many other disciplines. The process of formation is important and complicated, each constituent element of society and nature has a special impact during this ongoing process, (taking into account that even the formed personality is already influenced by external factors), therefore early childhood it is a sensitive period where great attention should be paid as the most comprehensive basis of construction, the formation of personality.

Keywords: Family, Children, personality, influence, process, society.

TABELA E PËRMBAJTES

ABSTRAKTI.....	2
ABSTRACT.....	3
HYRJE.....	7
KAPITULLI I	9
SHQYRIMI I LITERATURES.....	9
1.1. Struktura e përgjithshme e familjes	9
1.2. Funksioni edukativ i familjes.....	11
1.2.1. Roli i familjes ne formimin e shprehive pozitive te fëmija.....	12
1.2.2 Prindërimi	13
1.2.3. Stilet e prindërimit	15
1.3. Ndikimi i ambientit familjar në formimin e personaliteti të fëmijës.....	17
1.4. Raportet familjare dhe ndikimi tek fëmija	18
1.4.1. Rrethi i ngushtë dhe i gjerë i familjes	19
1.5. Ndikimi i faktorëve ekonomikë dhe socio-kulturorë në edukimin e fëmijës në familje.....	20
1.5.1. Këndvështrimi socio-kulturor i Vigotskit	21
1.5.2. Ndikimi ekonomik	22
1.6. Metodat dhe mjetet edukative të familjes në edukimin e fëmijës	22
1.6.2. Mësimi përmes shembujve.....	23
1.6.3. Dashuria për ambientin që e rrethon	24
1.6.4. Roli i mikro-mjedisit dhe i makro-mjedisit në edukimin e drejtë të fëmijës	25
1.7. Parakushtet për edukim të suksesshëm	26
1.7.1. Zgjedhja e partnerit (martesa) si parakusht për edukimin e suksesshëm të fëmijëve ..	27
1.8. Teoritë e personalitetit	28
1.8.1. Teoria psikoanalitike e Freud (Frojdit)	28
1.8.2. Teoria analitike e Karl Jungut.....	29
1.8.2. Teoria individuale e personalitetit e Alfred Adlerit	29
1.8.5. Teoria e Gordon Allport.....	29
KAPITULLI II.....	32
METODOLOGJIA E HULUMTIMIT	32
2.1. Objekti i hulumtimit.....	32
2.2. Qëllimi i hulumtimit	32
2.3. Detyrat e hulumtimit	32
2.4. Metodat dhe teknikat e hulumtimit	33
2.5. Pyetjet e hulumtimit dhe hipoteza.....	33
2.6. Instrumentet matëse	33
2.7. Popullacioni dhe mostra e hulumtimit	34

2.8. Organizimi i hulumtimit.....	34
2.9. Përpunimi statistikor i të dhënave.....	34
KAPITULLI III.....	36
REZULTATET E HULUMTIMIT.....	36
KAPITULLI IV	46
DISKUTIMET	46
PËRFUNDIMET.....	49
REKOMANDIME	51
LITERATURA	52
SHTOJCA.....	56

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Paraqitja tabelare e numrit të fëmijëve dhe përqindja relative e tyre.....	36
Tabela 2. Paraqitja tabelare e arsimimit të prindërve dhe përqindja relative e tyre.....	37
Tabela 3. Palanifikimi i familjes.....	37
Tabela 4. Paraqitja tabelare e moshës së fëmijëve dhe përqindja relative e tyre.....	38
Tabela 5. Paraqitja tabelare e moshës së fëmijëve dhe përqindja relative e tyre.....	38
Tabela 6. Paraqitja tabelare e stileve të prindërimit dhe përqindja relative e tyre.....	38
Tabela 7. Të dhënat deskriptive për ambientin familjarë dhe personalitetin e fëmijëve.....	39
Tabela 8. Korrelacioni në mes ambientit familjar dhe persinalitetit tek fëmijët.....	40
Tabela 9. Korrelacioni në mes ambientit familjar, personalitetit të fëmijëve dhe stileve të prindërimit.....	41
Tabela 10. Të dhënat deskriptive të sileve të prindërimit me ambientin familjar.....	42
Tabela 11. ANOVA për stilet e prindërimit në kontekst të ambientit familjar.....	42
Tabela 12. Dallimet në mes planifikimit dhe mos planifikimit familjar në kontekst të ambientit familjar.....	43
Tabela 13. Dallimet në mes planifikimit dhe mos planifikimit familjar në kontekst të ambientit familjar përmes T-testit.....	44
Tabela 14. Paraqitja tabelare e dallimeve gjinore në kontekst të personalitetit të fëmijëve.....	45
Tabela 15. Parqitja tabelare e dallimeve gjinore në kontekst të personalitetit të fëmijëve përmes T-testit.....	45

HYRJE

Familja si bashkësi është institucioni i parë bio-psiko-social në të cilin krijohet, zhvillohet, rritet dhe edukohet fëmija. Familja (lat. famulus – rob shtëpie), është njësi shoqërore më e vogël duke filluar nga dy ose më tepër persona të cilët kanë midis vete lidhje martesore, gjaku ose besimi, jetojnë në të njëjtin mjedis, kanë marrëdhënie kulturore, ekonomike të përbashkëta dhe kujdesen për njëri tjetrin. Roli i ndikimit të ambientit familjar, pra saktësisht familjes së ngushtë, prindërve, në edukimin e fëmijës, është faktor kyç në formimin e personalitetit të tij/saj, duke mos lënë anash edhe faktorët e tjerë dhe familjen e gjerë të cilët plotësojnë dhe ndihmojnë këtë zhvillim.

Personaliteti mund të përkufizohet si një grup karakteristikash e tipare të organizuara të një personi, shumë nga këto tipare e karakteristika lidhen me gjenetikën e individit, pra zinxhirin gjenetik të prindërve, dhe familjar e gjerë ku përfshihen gjyshërit, apo anëtarët e tjerë të familjes. Të gjithë këta përbëjnë ambientin familjar, mjedisin e parë social në të cilin ekspozohet fëmija dhe ku ai fillon të formohet si një individ i veçantë krahas gjenetikës dhe ambientit që e rrethon.

Shumë faktorë ndikojnë në ambientin familjar gjatë formimit të personalitetit të një fëmije, duke lënë gjurmë në karakteristikat sociale, psikologjike e morale në personalitetin e tij ndërtimin e një individi në shoqërinë e ardhshme. Faktorët më me ndikim në rritjen dhe mirëqenien e një fëmije janë të shumtë. Por, padyshim se një ndër ta si më i rëndësishmi është faktori prind dhe marrëdhënia në mes të dy prindërve nëse fëmija ka fatin ë rritet me të dy bashkë. Faktor tjerë me rëndësi theksohen edhe mjedisi, kultura, arsimimi e po ashtu edhe faktori ekonomik si i një rëndësie të theksuar duke marrë parasysh se i paraprin shumë aspekteve tjera të zhvillimit dhe ndërtimit të jetës së një familje, fëmije. Bashkëveprimi i këtyre faktorëve duhet të ndjekë një qëllim, të mos lejojë luhatje dhe infiltrime në qëllimin e caktuar për rritjen, edukimin dhe mirëqenien e fëmijës, në mënyrë që t'i shmangemi devijimeve, deformimeve të personalitetit gjatë formimit të tij. Një përpjekje e vazhdueshme e familjes sot, është harmonizimi i nevojave dhe interesave të fëmijës, krahas zhvillimeve dinamike në shoqëri, e në veçanti në fushën e teknologjisë, e cila çdo ditë po ofrohet në paralele me edukimin dhe po bëhet pjesë e përditshmërisë, ndërsa edukimi po bëhet çdo ditë e më sfidues. Për tu ballafaquar me këtë sfidë dhe për të arritur qëllimin e suksesit në krijimin e familjes së shëndoshë dhe fëmijëve me personalitet të qëndrueshëm, sigurisht pedagogjizmi i familjes është i një rëndësie që dominon fuqishëm në këtë proces. Në një familje ku prindërit

kanë një arsimim të lartë sigurisht se priten edhe rezultate më të favorshme në edukimin e fëmijëve duke u nisur nga parimi që përpjekja për ti shfrytëzuar mundësitë dhe lehtësimet në punë e mësim që kanë arritur një nivel tjetër krahas zhvillimit teknologjik ti përdorin në formën më të arsyeshme të mundshme e po ashtu edhe me një kontroll në përdorimin e tyre. Një sfidë tjetër sot është edhe kontrolli në përdorimin e pajisjeve të ndryshme nga ana e fëmijëve ku prindërit mund të kenë njohuri bazike, mund edhe të mos kenë fare apo edhe të tillë që janë në hap me kohën dhe zhvillimin, prandaj shkalla pedagogjike e prindërve luan rol tejet të rëndësishëm në formimin, zhvillimin dhe edukimin e fëmijëve.

KAPITULLI I

SHQYRIMI I LITERATURES

1.1. Struktura e përgjithshme e familjes

Familja, rrjedh nga (lat. familia, famulus, rod shtëpie- shërbëtor) gjuha e vjetër latine që nënkupton anëtarin e familjes, pra robin e shtëpisë. Familja është njësi më e vegël shoqërore, ajo mund të përbëhet edhe nga vetëm 2 persona të cilët kanë në mes tyre lidhje gjaku, besimi, kulture, jetojnë në të njëjtin mjedis dhe kujdesen për njëri tjetrin.

Kur përmendim etimologjinë e fjalës familje pra rob shtëpie - shërbëtor, vetë kuptimi i saj thirret në shërbim ndaj asaj që i takon, në këtë rast mjedisit familjar. Nuk mund të quhet familje dhe as të jetë pjesë e saj dikush i cili nuk ka tipare të njëjta me grupin, lidhshmëri apo edhe nuk i përshtatet kontributit për krijimin, ruajtjen dhe mirëqenien e po atij grupi, pra familjes.

Ekzistojnë shumë përkufizime për familjen. Zyra e regjistrimit të përgjithshëm e Shteteve të Bashkuara, familjen e ka përkufizua si “dy apo më shumë persona lidhur nga lindja, martesë, ose adoptimi të cilët jetojnë së bashku” (Deklarata e Përgjithshme mbi të Drejtat e Njeriut, 16 (3), që është edhe përkufizimi më i thjeshtë dhe i saktë që përkufizon, përkufizon, përshkruan përbërjen familje.

Familja është komuniteti i parë që shumica prej nesh e njohim, është terreni i ku ne trajnohemi, mësohemi se si të sillemi në bashkësi me njerëzit e tjerë. Në familje ndërtojmë mendimet e para dhe të kuptuarit, qasja fillestare me edukimin.

Familja si bashkësi është institucioni i parë bio-psiko-social në të cilin krijohet, zhvillohet, rritet dhe edukohet fëmija.

Kur flitet për tipat e familjes përmenden disa lloje, mirëpo tani do të ndalemi në strukturën e familjes bërthamë (nukleare). Ky lloj i familjes është mbizotërues në shoqëritë tona. Struktura e saj përbëhet nga nëna (femër), babai (mashkull) dhe pasardhësit e tyre, pra fëmijët.

Anëtarët e një familjeje bërthamë janë

- Nëna: prindi femër

- Babai: prindi mashkull
- I biri: mashkulli i lindur nga nëna, i atësuar nga babai,
- E bija: femra e lindur nga nëna, atësuar nga babai, - apo e lindur nga nëna atësuar nga babi tjetër, ose mëmësuar nga nënë tjetër.

Familja bërthamë ndërtohet mbi parimet e jetës bashkëshortore dhe fëmijëve, pra kjo nënkupton se fëmijët mund edhe të mos kenë të dy prindërit biologjik por të jenë të mëmësuar apo të atësuar nga njëri apo tjetri prind, gjithashtu familja e tillë mund të mos ketë asnjërin nga prindërit biologjik por të jenë fëmijë të adoptuar e që kanë dy prindër në përkujdesje, rritje dhe edukim (Kraja, 2005).

Një familje më e zakonshme dhe më ideale do të ishte ajo familje e ndërtuar mes dy bashkëshortëve dhe fëmijëve të tyre të lindur nga nëna biologjike dhe bashkëshorti i saj pra rrjedhimisht babai biologjik. Trashëgimia gjenetike, bartja e gjeneve nga prindërit tek fëmija, luan një rol të rëndësishëm në aspektin fizik dhe atë psikik të fëmijëve. Gjenotipi, materiali gjenetik që përmban një individ e i cili është i marrë nga prindërit përcakton shumicën e tipareve të tij. Mirëpo ka dhe një lidhje të gjeneve e cila quhet ‘*Lidhja pasive gjene-mjedis*, ndodh kur prindi (personi që i jep gjenet fëmijës) përcakton edhe mjedisin ku fëmija do të rritet dhe edukohet (Kraja, 2005). Një gjë e tillë përcaktohet pa ndonjë qëllim, prindi sjell në jetë fëmijën në po atë mjedis në të cilin e ekspozon edhe veten e tij, pra aty ku jeton, por ajo që fëmija ka në zinxhirin trashëgues më vonë e drejton në një ‘*Lidhje aktive gjene-mjedis*. Në këtë rast, vetë fëmija kërkon në mënyrë aktive atë mjedis që i përshtatet më mire atij.’. Pra fëmija përcakton mjedisin në bazë të prirjeve dhe potencialeve që ka, p.sh ai që ka prirje për të shkruar zgjedh një mjedis që ofron librin. Lidhja aktive e gjeneve me mjedisin vazhdimisht fuqizohet dhe rritet, ky fakt ndikon në pavarësimin e individit dhe largimin përherë e më shumë nga prindërit në kuptimin pozitiv dhe stimulimin, përmbushjen e potencialeve vetjake (Kraja, 2005).

Një familje bërthamë e krijuar nga bashkëshortë dhe fëmijët e tyre biologjik, është edhe më e suksesshme duke u mbështetur në faktet që i përmendëm më lartë. Për çdo prind do të jetë më e lehtë të kuptojë, drejtojë, edukojë e udhëzojë një fëmijë ku parimisht njeh potencialet e tij nga baza gjenetike, gjithashtu një nënë e cila mbart atë fëmijë për nëntë muaj në barkun e saj, domosdo që do ta njohë më mirë çdo reagim të fëmijës së saj, duke u mbështetur edhe në fazat që ka kaluar në periudhën e shtatzënisë. ‘Konteksti i parë i zhvillimit të individit është mitra e nënës. Shkencëtarët po zbulojnë gjëra të reja rreth efekteve të këtij mjedisi të parë ku përfshihen: roli i nivelit të stresit që kalon nëna shtatzënë, mënyra e ushqimit të saj,

konsumimi i duhanit, konsumimi i alkoolit dhe drogave, ushtrimet e saj fizike dhe gjendja e saj e përgjithshme shëndetësore gjatë periudhës së shtatzënisë (Woolfolk, 2010).

1.2. Funkzioni edukativ i familjes

Cilësia dhe fuqia e ndikimit edukativ të familjes varet nga shkalla e pedagogjizimit të familjes, respektivisht, nga ajo se sa është familja “veprues i qëllimshëm dhe i organizuar edukativ (Samilaniq & Toliçiç, 1976). Njëkohësisht efekti edukativ i familjes kushtëzohet në një anë, nga harmonizimi i qëllimeve dhe veprimeve edukative të familjes me faktorët e tjerë edukativë, dhe në anën tjetër, nga shkalla e koordinimit dhe veprimeve edukative të faktorëve të tjerë edukativë me familjen (Shaffer, 1979).

Stili i martesës në prindërim quhet ‘prindërimi me ngrohtësi dhe përkujdesje’, një stil që nxjerr në sipërfaqe më të mirën tek prindi dhe fëmija (Sandahl & Alexander, 2016).

Martesa nënkupton lidhjen në mes dy individëve në të shumtën e rasteve nga gjini të kundërta, mashkull dhe femër të cilët gjejnë tek njëri tjetri partnerin që mendojnë se është i përshtatshëm për ta në krijimin e familjes dhe për të kaluar pjesën tjetër të jetës së bashku.

Martesa është bashkëjetesa ligjore, e cila mbështetet në barazinë morale dhe juridike të bashkëshortëve, në ndjenjën e dashurisë, respektit dhe mirëkuptimit reciprok si baza të unitetit në familje. (‘Kodi i Familjes dhe legjislacioni për birësimet i Republikës së Shqipërisë’). Martesa me të drejtë quhet institucion i shenjtë në të cilin është tejet e rëndësishme ndjeshmëria emocionale, prania fizike, socio-ekonomike, niveli arsimimit dhe edukimit të partnerit, rrethanat dhe kultura ku mendohet të ndërtohet ajo. Filozofi E.Kanti martesës i dha një vlerë të jashtëzakonshme në jetën dhe zhvillimin e saj duke e përkufizuar kështu’’ *mashkulli dhe femra bashkërisht përbëjnë njeriun*’’, pra që jeta të ketë kuptim dhe vazhdimësi është e pashmangshme lidhja në martesë (Deva-Zuma, 2003).

Njeriu si qenie shoqërore dhe e vetëdijshme, i matshëm në veprimet që bën adaptohet në rrethana e kultura të ndryshme, varësisht se ku e zhvillon jetën e tij. ‘Adaptimi në çdo rrethanë të re është aftësi e njeriut. Por, adaptimi në martesë është proces poliedrik, që ngërthen adaptimin e çiftit në aspektin organik, fizik, të shprehive, në aspektin social, qasjes ndaj jetës etj., gjithnjë me qëllim të zhvillimit dhe ruajtjes së këtij institucioni, zhvillimit dhe ruajtjes së marrëdhënieve bashkëshortore dhe njerëzore, gjithnjë me qëllim të afirmimit të

familjes dhe identitetit personal dhe çiftit në bashkëshortësi. (Deva- Zuna, Nimonaj- Hoti, 2017).

Gjithnjë kur flasim për martesat, nuk mund te shkëputet familja. Pra martesës por jo domosdo i paraprin krijimi i familjes së re që nënkupton prindërit dhe fëmija, lindja e fëmijëve. Duke mos përjashtuar se familje quhet edhe grupi nga vetëm dy persona pra bashkëshortët, kësaj i jep kuptim më të fuqishëm pasardhësit e tyre, fëmijët (Adler, 1978).

Kur dy bashkëshortët lidhin kurorën e tyre të bazuar në respekt, besim e dashuri, një ngjarje me shumë emocion për këtë familje është fëmija. Planifikimi i fëmijës është bazament i sigurt edhe për edukimin e tij, pranimin e ardhjes së tij në jetë pa luhatje emocionale të nënës apo edhe babait, marrja me dëshirë e përgjegjësive si prindër ndaj fëmijës që ata të dy do të rrisin dhe edukojnë. Në të kundërtën kur martesa mund të jetë e lidhur në interesa qoftë nga njëra palë apo edhe të dyja, sikur qëllimi i përfitimeve financiare, ato të karrierës, kur nuk ka besim dhe respekt brenda shtëpisë së çiftit të ri, mungesa e dashurisë etj., ardhja në jetë e fëmijës do të përcillet me luhatje emocionale nga të dy partnerët, gjë e cila do të ndikojë edhe në rritjen dhe formimin e personalitetit të fëmijës që ata kanë sjellë në jetë (Adler, 1978).

Gjithsesi si përfundim nga ajo se çka shoqëria na ka ofruar deri më sot, një martesë me bazë të shëndoshë dhe me dashuri është çelësi i një familje të ndritur me pasardhës që premtojnë suksese.

Sa herë që ndërhyjmë te fëmijët, duhet të kemi për qëllim t'i ndihmojmë të mësojnë se si duhet të sillen dhe t'u shërbejmë mirë si të rritur (Biduph, 1998). Ne të gjithë kemi mendime herë pas here se çfarë do të thotë.

1.2.1. Roli i familjes ne formimin e shprehive pozitive te fëmija

Për shkak se ne nuk kemi lindur duke ditur si të sillemi në shoqëri, ne duhet të mësojmë shumë nga sjelljet nga mjedisi përreth nesh që rritemi. Për shumicën prej nesh, ky mësim fillon me familjen në shtëpi.

Të mësuarit ka shumë forma. Ndonjëherë fëmijët mësojnë duke u thënë diçka drejtpërdrejt. Sidoqoftë, mënyra më e zakonshme që fëmijët mësojnë është vëzhgimi i jetës së përditshme. Të mësuarit dhe shoqërimi i një fëmije ndikohet më së shumti nga familja e tij pasi familja është grupi kryesor shoqëror i fëmijës. Sipas Psikologes Dr. Rashmi Prakash e cila shkruan në blogun “firstcry parenting” thotë: Anëtarët e familjes janë njerëzit e parë me të cilët një fëmijë ndërvepron dhe, kështu, roli i familjes në shoqërimin e një fëmije nuk mund të

minoher. Këto mund ta ndihmojnë një fëmijë të ketë një kuptim më të mirë të vetvetes dhe të njerëzve përreth tij. Mënyra se si një fëmijë është i dashur, kujdesur dhe edukuar në shtëpi siguron mundësitë që një fëmijë të lulëzojë më mirë në jetën e tij. Ndikimi i një familje në zhvillimin e fëmijës është si një themel, i cili mund të ndihmojë në formësimin e së ardhmes së një fëmije.

Kërkimet e fundit në lidhje me familjen e përcaktojnë konceptin e saj si një mjedis të privilegjuar të formimit të personalitetit dhe duke e kufizuar, pra, ai ka një rol themelor në zhvillimin e fëmijëve të vegjël dhe adoleshentëve (Berry, Kagitçibasi, Georgas, Poortinga, & Van de Vijler, 2006; Relvas & Vaz, 2007).

Koncepti i familjes ka ndryshuar dhe vuajtur një evolucion të rëndësishëm në lidhje me seksualitetin diferencimi, faktorët biologjikë dhe funksioni i burrave dhe grave në simbolet dhe ndalimet. Të gjitha këto kanë rëndësi për evolucionin shoqëror. Këto ndryshime do të kenë pasoja edhe në strukturën e familjes si në funksionimin e tij (Bayle, 2005). Gjatë një kohe të gjatë, fëmija zinte një vend periferik në familje. Sidoqoftë, me kalimin e kohës, fëmija bëhet qendror në jetën familjare (Leal, 2005).

1.2.2 Prindërimi

Njeriu mbart me vete një trashëgimi të caktuar biologjike, mbartësi të gjeneve të cilat i trashëgon kryesisht nga prindërit. Prindi është një kujdestar i pasardhësve të tij, ku në këtë rast i referohemi fëmijëve. Prindërit mbeten gjithmonë prindër të fëmijëve, qofshin ata të rritur apo ende në përkujdesje të plotë dhe të varur nga prindi. Gjithashtu prindërit mbartin përgjegjësinë morale dhe ligjore deri në moshën kur fëmija konsiderohet një individit i pavarur plotësisht sipas ligjit, pra në moshën e përcaktuar, 18 vjeç sipas nenit 1 në Konventën mbi të Drejtat e Fëmijëve, Miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 20 nëntor 1989, ku thuhet:

Në këtë Konventë, me fëmijë kuptohet çdo qenie njerëzore nën moshën 18 vjeç, me përjashtim të rasteve kur mosha madhore arrihet më përpara, në përputhje me legjislacionin të cilit ai i nënshtrohet (Sideris, 2010).

Para se të flasim për prindërimin ndaj fëmijëve, është me rëndësi të ceket se jo vetëm baza biologjike jep të drejtën të jesh prind, pra kemi edhe rastet kur prind mund të bëhet edhe përmes procesit të adoptimit, gjithashtu me zhvillimet e fundit të teknologjisë në fushën e mjekësisë me fekondim artificial të fetusit, fëmija mund të ketë një nënë biologjike dhe një

baba që nuk mbart gjenet e tij, mirëpo kjo nuk i liron ata nga marrja e përgjegjësisë dhe kujdesit prindëror, obligimet dhe normat morale ndaj rritjes së fëmijës, pra ‘Gjëja e parë dhe absolute që kërkohet është të ekzistojnë prindër (Sideris, 2010).

Prindërimi është një shqetësim i vazhdueshëm dhe madje shumë kompleks në shoqërinë e sotme. Fillimisht pasiguria për të qenë prind, heqja dorë nga ‘liria’ individuale, kujdesi vetëm për veten, përgjegjësia dhe përkushtimi ndaj një fryti që vetë e sjellin në jetë përfshi këtu edhe dinamikën në të cilën jetojmë, janë vetëm disa nga elementet dhe vështirësitë që e presin një nënë dhe baba. Mirëpo të gjitha këto nuk e lënë të zbehet dëshira dhe dashuria për të pasur fëmijë. Por, sigurisht se nuk mjafton vetëm dëshira dhe dashuria për ta rritur një fëmijë. Me vetë fëmijën edhe prindi rifillon edukimin e tij dhe sfidën e kënaqshme për atë që pret nga vetja dhe fëmija. Shkalla e edukimit, pedagogjizmi i prindërve luan rol shumë të rëndësishëm. Kur prindërit njohin pozicionin e tyre karshi fëmijës, paracaktajnë qëllime të përbashkëta për edukimin e tij dhe njëkohësisht respektojnë potencialet e natyrës së fëmijës, sigurisht se ata po ndihmojnë në formimin e një individi të shëndoshë, të mirëqenë për shoqërinë e së ardhmes. Kësaj çështje, pra rolit të prindërve një mbështetje të madhe në shkrimet e tij i jep edhe mjeku, psikanalisti, psikiatri, profesori i psikanalizës Dr. Nikos Sideris i cili e krahason atë me gjërat më elementare për ekzistencën e qenies njerëzore, ushqimin dhe ujin, ndër të tjera thotë: Në çdo rast, në formimin e një fëmije ekzistenca e prindërve në vendin dhe rolin e tyre, që funksionojnë në më të mirën e mundshme, siç e kërkon cilësia e prindit, është po aq e nevojshme sa ushqimi dhe uji. Dhe këtë fëmijët e dine mirë (Sideris, 2010). Pra, fëmijët kanë nevojë të pazëvendësueshme për prindërit e tyre.

Pjekuria emocionale dhe ajo pedagogjike e prindërve manifestohet me qëndrueshmëri dhe korrektësi të veprimeve e vendimeve në raport me lindjen dhe edukimin në frymën pozitive të fëmijës, sikurse që papjekuria krijon dukuri negative si mos disiplina, pasiguria, mosbesimi etj., që më vonë shfaqen tek fëmijët, pra nuk është dhe aq e thjeshtë të marrësh epitetin prind. Prindërit kanë një mision tejet të rëndësishëm. Ata janë të vetmit që mund ti mbrojnë fëmijët duke u bashkuar dhe punuar bashkërisht për të mirën e shoqërisë. Ata duhet ta përmbushin misionin të cilin ua ka besuar natyra Dr. Montessori (1972) fliste në këtë mënyrë për rolin e prindërve në edukimin e fëmijëve, ndër të tjera ajo i bënte përgjegjës prindërit për të ardhmen e shoqërisë, meqenëse janë ata të cilët sjellin në jetë fëmijë. Gjithashtu prindërit nuk do të duhej ta konsideronin veten sikur prodhuesit e fëmijës por sikur kujdestarët e tij. Pra, jo vetëm të bëhet por të mirërritet dhe edukohet në praninë e tyre dhe me dashurinë e tyre, kjo

do t'i jepte kuptim dhe do ta plotësonte misionin e tyre si prind (Montessori, The secret of childhood, 1972).

1.2.3. Stilet e prindërimit

Në hulumtimet dhe studimet e sotme ka mendime, shkrime, publikime të shumta për martesat, familjet dhe stilet e prindërimit. ‘‘Pavarësisht se kush është përgjegjës për rritjen e fëmijës, studimet kanë treguar se ekzistojnë dallime thelbësore në stilet e prindërimit (Woolfolk, 2010).

Një nga studiuesit e shumtë të kësaj fushe është edhe Diane Baumrindi, e cila gjatë viteve 1991, 1996 bëri kërkimet më të njohura deri më sot për stilet e prindërimit, të cilat kryesisht ishin të përqendruara në studimin e saj gjatësor të 100 fëmijëve parashkollorë shumica prej të cilëve i takonin shtresës së mesme euro-amerikanë.

Baumrindi theksoi 4 stile të prindërimit: prindërit me autoritet, prindërit autoritar, prindërit tolerant dhe prindërit refuzues.

- Prindërit me autoritet ‘‘(shumë dashuri, shumë kontroll) përcaktojnë qartazi kufijtë dhe presin që fëmijët e tyre të sillen si të pjekur (Woolfolk, 2010).

Këta prindër me dashurinë që kanë shprehin edhe ngrohtësi me fëmijët e tyre, dëgjojnë shqetësimet e tyre, vendosin rregulla për të cilat edhe japin shpjegime dhe vendosin në mënyrë demokratike për zbatimin e tyre. Në këtë stil prindërimi ka më shumë orientim e udhëzim dhe fare pak ndëshkim e sidomos ndëshkime të rrepta. Prindërit i ndihmojnë, këshillojnë fëmijët që të mund ti parashikojnë pasojat e veprimeve të tyre dhe kështu hapësira për ndëshkim nga ana e tyre mbetet e pakët. ‘‘Me një bisedë në atë masë që qëndrimi i prindërve ofron *dashuri dhe rregulla*, fëmija do të formohet dhe do të jetojë me *dashuri dhe me ekuilibër*. Nëse nuk respektohet ky parim i lartë – *dashuri dhe rregullat* – atëherë fillojnë të ndodhin shtrembërime, përplasje, prishje të ekuilibrave si dhe debate me fjalë të shumta dhe boshe që as e ndriçojnë dhe as e ekuilibrojnë situatën (Sideris, 2010).

- Prindërit autoritarë (pak dashuri, shumë kontroll) paraqiten të ftohtë dhe kontrollues në ndërveprimet e tyre me fëmijët (Sideris, 2010).

Prindërit autoritarë vendosin rregulla për të cilat nuk japin shpjegim te fëmijët e tyre, këta presin zbatim dhe nëse u kërkohet shpjegim nga ana e fëmijëve përdorin thjesht

autoritetin dhe përgjigjja e vetme është ‘‘ Sepse unë thash kështu’’. Nëse nuk respektohet rregulli ose fjala rezulton me dënime të ashpra. ‘‘Sipas Baumrind, këta prindër janë të bindur dhe të orientuar drejt statusit dhe presin që urdhrat e tyre të zbatohen pa sqarim (Cherry, 2011). E gjithë kjo nuk nënkupton se mungon dashuria ndaj fëmijëve të tyre, edhe pse nuk flitet për emocion në këtë lloj stil prindërimi, ata thjesht nuk e shprehin dashurinë ndaj fëmijëve të tyre.

- Prindërit tolerantë (shumë dashuri, pak kontroll). Prindërit e tillë janë të mendimit se fëmijët nuk do të duhej të kenë shumë rregulla apo të kërkohet që të sillen si të pjekur, fëmijët thjesht janë fëmijë (Cherry, 2011).

Mirëpo a është mënyra e duhur kjo karshi fëmijëve, rezultatet kanë treguar se fëmijët me prindër të tillë në të ardhmen kanë prirje të jenë impulsiv, shfaqje agresiviteti, pa qëllime të caktuara në jetë dhe kanë aftësi të ulët vetëkontrolli. Fëmijë të tillë kanë më pak gjasa të arrijnë suksese në jetë. Psikanalisti Nikos Sideris (2010), mbështet mendimin se një prindërim i tillë nuk është për tu lavdëruar, ai thekson se ‘‘në një shtëpi të gjithë janë të barabartë sa i takon dinjitetit të tyre, por njëkohësisht janë asimetrik sa u takon vetive, cilësive të tyre. Sipas tij është absurditet që të vegjël dhe të mëdhenj të mendojnë se çdonjëri është kapiteni brenda shtëpisë. Kur në një shtëpi nuk ka rregulla, atëherë të gjitha degradojnë, prandaj tolerance e tepërt, dhe mungesa e rregullit e disiplinës nga prindërit mund ta llastojë fëmijën deri në atë masë sa prindi duhet të bëjë çdo gjë që fëmija i tij kërkon. Në të ardhmen kjo jep rezultate jo të mira për jetën e tij, pavarësisht se këta prindër janë të ngrohtë e të kujdesshëm (Sideris, 2010).

- Prindërit refuzues (pak dashuri, pak kontroll), këta prindër duket sikur nuk kanë interes për komunikimin, bashkëpunimin apo mësimin e fëmijëve të tyre.

Studimet e deritanishme tregojnë se: deri tani prindërimi i stilit autoritar, orientues dhe i kombinuar me ngrohtësi e mbështetje emocionale ka dhënë rezultatet më të mira në rritjen dhe edukimin e fëmijëve. Fëmijët të cilët janë rritur në praninë e prindërve të tillë dinë si të kenë prioritete, rregulla dhe synime të cilat do ti arrijnë në jetën e tyre (Sideris, 2010).

Ndikimi i familjes në formimin e personalitetit të fëmijës është një fushë studimi mjaft e gjerë, shumë interesante dhe tejet sfiduese. Hulumtime të shumta, studime, artikuj dhe literatura në fushat e edukimit, psikologjisë, sociologjisë, kryesisht pra shkenca që studiojnë shoqërinë, teori të shumta që flasin për sjelljen dhe personalitetin e individin, japin përgjigje nga më të ndryshmet në lidhje këtë temë.

1.3. Ndikimi i ambientit familjar në formimin e personaliteti të fëmijës

Familja, padyshim, është ndër faktorët më me rëndësi për zhvillimin e personalitetit të fëmijës. Ajo jo vetëm që është “foleja”, mjedisi më i përshtatshëm dhe njëherësh i parë shoqëror, ku prindërit kujdesen për fëmijë, por aty fëmija fiton shprehitë e para, formon qëndrime të caktuara, i krijon vlerat dhe virtytet njerëzore. Fëmija mësimet e para i merr në familje, në kontakt me prindërit e tij, ai identifikohet me ta (Sulloey, 1996). Ambienti familjar, pjesëtarët, anëtarët e familjes pa dyshim se janë faktor me shumë ndikim në edukimin e fëmijës, por jo të vetmit.

Njohuritë për zhvillimin e funksioneve të veçanta na ndihmojnë që ta kuptojmë më së miri nëse e drejtojmë vëmendjen ndaj aspekteve të integruara të personaliteti (Samilaniq & Toliçiç, 1976)

Çdo fëmijë lind në një ambient të quajtur familje, qoftë edhe nëse nuk rritet brenda saj, ai rrjedh nga ajo familje në të cilën ka lindur. Edhe në rastet kur nuk rritet me të apo pa të, në të dyja familja ka ndikim, sikur kur edukon ashtu edhe kur ajo mungon. Me sa shohim është tërësisht e pashmangshme ndikimi i faktorit familje dhe ambientit të saj në edukim. Edukimi i përkryer do të reduktohej në një fjali: Ofro vetëm dashuri, bëhu vetëm dashuri. Por në botën në të cilën jetojmë, fëmijët rriten të përballur me marrëdhënie të shumta që nuk mbështeten në dashuri, në radhë të parë jashtë familjes, por ndonjëherë edhe në familje (Chopra). Familja, me të drejtë konsiderohet si faktor i rëndësishëm i edukimit dhe formësimit të personalitetit. Cilësia dhe fuqia e ndikimit edukativ të familjes varet nga shkalla e pedagogjizimit të familjes, respektivisht, nga ajo se sa është familja “veprues i qëllimshëm dhe i organizuar edukativ (Rowe, 1994).

Fëmija edukohet nga çdo gjë që e rrethon, dhe meqenëse si ambienti i parë i tij është familja dhe vendet ku ajo e drejton nënkuptohet se është roli i saj dominant në edukimin që pason të ketë ai fëmijë. Sigurisht se në kuptimin e ngushtë janë prindërit dhe fëmija përbërja e një familje, dhe barra e krijimit të një ambienti pozitiv, edukues, formues bie mbi ta, prandaj edhe është me rëndësi që të zgjedhin parime e rregulla të përbashkëta, të harmonizuara për të edukuar, rritur e formuar fëmijën e tyre (Templar, 2013).

1.4. Raportet familjare dhe ndikimi tek fëmija

Duhet theksuar se një martesë e lidhur në parime të përbashkëta, dashuri të pastër pa interesa dhe që për qëllim të së ardhmes ka krijimin e familjes, lindjen e fëmijëve është idealja për të rritur dhe edukuar në një drejtim dhe me harmonizim të plotë të qëllimeve prindërore në të mirën e përbashkët të familjes dhe fëmijës. Ambienti në shtëpi, rendi dhe rregulli janë pjesë e rëndësishme e prindërimit, roli i nënës ai i babait bashkëpunimi e ndërveprimi mes vete karshi fëmijës janë çelësi kryesor në organizimin e familjes ku rritet ai fëmijë. Fëmija mësimet e para i merr në familje, në kontakt me prindërit e tij, ai identifikohet me ta. (Spahiu, 1999). Prindërit kanë një mision tejet të rëndësishëm. Ata janë të vetmit që mund t'i shpëtojnë fëmijët e tyre duke u bashkuar dhe duke punuar së bashku për përmirësimin e shoqërisë. (Montessori, 1972).

Për fëmijën prindi është ajo krijesë që i garanton atij se përgjigja e kësaj pyetje është pa kushte: 'Po bota mua më do-do që unë të ekzistoj'. Këtë gjë ia garanton, para së gjithash, përmes faktit kryesor-se prindi dëshiron që të ekzistonte fëmija i tij dhe se për këtë arsye solli atë në jetë. (Sideres 2010). Një gjë e tillë ndikon që fëmija të ndihet i rëndësishëm dhe i dëshirueshëm për prindërit e tij e që rritë vlerësimin dhe respektin e tij për veten, që janë përbërës me ndikim të një personaliteti të forte në të ardhmen. Është konstatuar se fëmijët që rriten pa prindër, që nuk kanë harmoni familjare dhe fëmijët që rriten pa njërin prind, janë të prirë për kriminalitet, për drogë, alkool, stres dhe për të pamira tjera. (M. J & V. N & C.D S. F & F.L). Në këto dy aspekte mund të vërejmë qartazi dallimin se s'i ndikon prindërimi pozitiv dhe s'i ai negative dhe familja e shëndoshë tek fëmija (Becker, 1964).

Shkalla dhe cilësia e pedagogjizimit të mjedisit familjar varet, po ashtu edhe nga konstitucioni i përgjithshëm i familjes në aspektin e plotnisë dhe përbërjes brezore të saj, nga madhësia e saj, nga mosha e prindërve dhe anëtarëve të tjerë të familjes, nga tiparet e personalitetit të prindërve dhe anëtarëve të tjerë të familjes, nga stabiliteti dhe karakteri i marrëdhënieve interpersonale familjare, nga mënyra se si zhvillohen këto marrëdhënie midis prindërve si dhe midis prindërve të fëmijëve, pastaj nga prezenca e dukurive asociale dhe anti-sociale në familje nga pozita e secilit individ në familje, si dhe nga prezenca e paragjykimeve të ndryshme në familje etj., (Deva, 2017).

Raportet ndërmjet anëtarëve të familjes dhe pozita e fëmijës në familje si dhe raportet familjare janë ndër faktorët e rëndësishëm të zhvillimit të personalitetit të shëndoshë, ku rolin

kryesor e luajnë prindërit, dashuria dhe kujdesi i matur dhe sistematik i tyre ndaj zhvillimit të fëmijës së tyre (Gjevori, 2005).

Njëkohësisht efekti edukativ i familjes kushtëzohet në një anë, nga harmonizimi i qëllimeve dhe veprimeve edukative të familjes me faktorët e tjerë edukativë, dhe në anën tjetër, nga shkalla e koordinimit dhe veprimeve edukative të faktorëve të tjerë edukativë me familjen (Pellai, 2013)

Sa here që ndërhyjmë te fëmijët, duhet të kemi për qëllim t'i ndihmojmë të mësojnë se si duhet të sillen dhe t'u shërbejmë mire sit ë rritur (Biduph, 1998). Ne të gjithë kemi mendime here pas here se çfarë do të thotë të jesh prind (Sandahl & Alexander, 2016).

Deri tani asnjëherë nuk është mohuar se disiplina pozitive, autoriteti prindëror pozitiv dhe përgjegjësia e familjes në detyrat që ka për fëmijën kanë dhënë rezultatet më të mira në të arriturat e fëmijës pavarësisht se në cilën fazë të rritjes është ai. Fëmija nuk merr edukim vetëm në veprime konkrete dhe momente të caktuara apo faza të rritjes ku prindërit ndikojnë qëllimshëm dhe në formë direkte, ata edukohen në çdo moment dhe sjellje që ju prezantohet me apo pa dashje në ambientin ku rriten. E rëndësishme nuk është vetëm që tu flasim fëmijëve, por që të flasim me ta dhe më e mira nga të gjitha ndoshta është që prindërit të flasin më pak dhe të dëgjojnë më shumë, hulumtim nga Rachel Romeo (2018), (world economy forum), How you talk to your child changes their brain.

1.4.1. Rrethi i ngushtë dhe i gjerë i familjes

Shumica e çifteve të sapo martuar sot planifikojnë të kenë vetëm një ose dy fëmijë, krahasuar me tre ose më shumë në fillim të viteve 1960. Arsytet për këtë ndryshim përfshijnë një prirje drejt martesës së mëvonshme, më shumë theks në karrierën për gratë, metoda më efektive të kontracepsionit dhe rritjen e kostos së rritjes dhe edukimit të fëmijëve.

Ka disa përfitime shumë të qarta për të pasur një familje të vogël; Secili fëmijë merr më shumë vëmendje prindërore dhe përparësi arsimore, të cilat në përgjithësi i rrisin vetëvlerësimin. Fëmijët në familje të vogla, veçanërisht fëmijët e parë dhe të vetëm, kanë tendencë të kenë nivele të larta të arritjeve në shkollë dhe në krahasim me fëmijët e familjeve të mëdha. Kostot financiare për mirëmbajtjen e një familje janë më të ulëta. Po ashtu është më lehtë për të dy prindërit të ndërthurin karrierën me jetën familjare.

Niveli i përgjithshëm i stresit është më i ulët sepse shpesh ka më pak konflikte dhe më pak rivalitet. Ka disa shkëmbime, veçanërisht në familjet me një fëmijë. Kur të gjitha pritjet, shpresat dhe frika përqendrohen vetëm te një fëmijë, prindërit mund të bëhen lehtësisht mbiprokurues dhe indulgjentë, madje pa e kuptuar. Fëmija mund të ketë më pak mundësi të takojë fëmijë të tjerë ose të zhvillojë një ndjenjë të pavarësisë. Ajo mund të shtyhet të mbivlerësojë, dhe mund të marrë kaq shumë vëmendje të errët sa të bëhet e përqendruar tek vetja dhe e padisiplinuar

.Caring for Your Baby and Young Child: Birth to Age 5 (Copyright © 2009 American Academy of Pediatrics) Marrëdhënia midis madhësisë së familjes dhe arritjeve arsimore të fëmijëve ka tërhequr shumë vëmendja në shkencat shoqërore. Sipas hipotezës së hollimit të burimeve, një fëmijë shtesë zvogëlon sasinë e kohës dhe mjeteve financiare që prindërit mund të kushtojnë për secilin fëmijë (Blake 1981; Downey 1995, 2001). Sa më e madhe të jetë familja, aq më e madhe është hollimi i burimeve prindërore, dhe më të kufizuara janë shanset arsimore të secilit fëmijë. Prandaj, prindërit përballen me një shkëmbim ndërmjet sasia dhe shanset arsimore të fëmijëve kur marrin vendime në lidhje me madhësinë e tyre familja (Becker dhe Lewis 1973; Becker dhe Tomes 1976). Mekanizmi i hollimit të prindërve burimet - nëse vërtet janë në punë - luan një rol kryesor nga pikëpamja e riprodhimit të shoqërisë pabarazitë. Duke pasur parasysh që fëmijët nga familje të mëdha mund të kenë shanse më të ulëta për të marrë adekuat edukimi, dhe në të njëjtën kohë për shkak të transmetimit ndërmjet brezave të preferencave të pjellorisë ata ka të ngjarë të krijojnë vetë familje të mëdha (Murphy dhe Knudsen 2002; Kolk 2014), të tyre pasardhësit përsëri mund të jenë në disavantazh.

1.5. Ndikimi i faktorëve ekonomikë dhe socio-kulturorë në edukimin e fëmijës në familje

Çdo individ,-fëmijë-lind dhe rritet në një grup të caktuar shoqëror, në një familje e cila i takon atij grupi. Gjate rritjes dhe zhvillimit të fëmijës, numri i faktorëve ndikues nuk është i vogël, përfshirë faktorët e brendshëm trashëgues dhe të jashtëm, ata që e përbëjnë rrethin shoqëror dhe familjen si vendi i parë social për fëmijën.

Kur flasim për ndikimin e familjes në edukimin e fëmijës, mundësitë e ndikimit të të gjithë faktorëve funksionalë në familje janë të mëdha. Familja funksionin e saj në edukim e plotëson me marrëdhëniet brenda familjes, zakonet që respektojnë, besimet dhe bindjet që dominojnë si faktorë ndikues në edukim si dhe në nivelin kulturor të saj.

Faktorët më me ndikim në formimin e personalitetit dhe zhvillimin e fëmijës konsiderohen rendi shoqëror në të cilin ai jeton, në këtë rast rendi dhe rregulli familjar, marrëdhëniet ndërpersonale që e përbejnë atë rreth, pra raportet ndërmjet prindërve dhe motrave e vëllezërve, qasja pozitive, e arsyeshme mes anëtarëve të familjes, gjë e cila e përgatit fëmijën si një individ, pjesëtar i shoqërisë në të ardhmen me ndikim të mirë dhe po të njëjtën qasje pozitive dhe të arsyeshme ndaj personave në rrethin e tij, e po ashtu edhe në sjellje reciproke ndaj familjes (Chopra, 2009).

1.5.1. Këndvështrimi socio-kulturor i Vigotskit

Në ditët tona, psikologët e pranojnë faktin se kultura i jep formë zhvillimit konjitiv, duke përcaktuar se çfarë dhe si do të mësojë fëmija për botën që e rrethon. Për shembull, vajzat e vogla nga fisi indian i Zinakantekos në Meksikën e Jugut e mësojnë teknologjinë e vështirë të endjes së pëlhurës nga mësimet informale të të rriturve në komunitetet e tyre (Woolfolk, 2010).

Pra, pa dyshim se fëmija zhvillon më shumë ato potenciale të cilat i gjen prezent në rrethin dhe kulturën në të cilën rritet, nga ajo se çfarë sheh në përditshmërinë e tij ku krijon shprehitë jetësore dhe bazën e njohurive dhe të shkathtësive për jetën e tij në të ardhmen (Buzan, 2007).

Çdo familje përcjell dhe kultivon kulturën e shoqërisë në mënyrën e saj. Kulturat që vlerësojnë bashkëpunimin dhe solidaritetin, i kultivojnë këto tipare që në moshat e hershme, kurse kulturat që ngrihen mbi konkurrencën, ushqejnë aftësitë konkurruese të të vegjlit e tyre (Bigner & Gerhardt, 2014).

Çdo funksion dhe ndikim në zhvillimin socio-kulturor të një fëmije shfaqet brenda tij në nivelin intra-psikologjik, prandaj është e rëndësishme që t'i kushtohet vëmendje çdo sjellje të të rriturve, e në veçanti brenda familjes duke marrë parasysh se domosdo ajo sjellje do të jetë edhe sjellje ose shprehje apo formim i fëmijës në të tashmen dhe të ardhmen (Adler, 1978).

1.5.2. Ndikimi ekonomik

Për shkak të kufizimit të burimeve familjare, prindërit e familjeve të varfra zakonisht nuk janë në gjendje të investojnë sa duhet në arsimimin e fëmijëve të tyre, gjë që ndikon në arritjet akademike të fëmijëve të tyre (Becker, 1964).

1.6. Metodatat dhe mjetet edukative të familjes në edukimin e fëmijës

Edukimi i fëmijëve është proces në vete me mjete dhe metoda të veçanta për të arritur qëllimin e caktuar në edukim të drejtë e të mirëfilltë në çdo institucion edukues e në veçanti në familje si institucioni i parë shoqëror dhe edukativ për fëmijën. Në shkencë nga koncepti metodë kuptohet rruga ose mënyra e studimit të asaj shkencë për njohjen dhe shpjegimin e ligjshmërive që ajo studion, ndërsa në filozofi teoria e parimeve teorike themelore që shërbejnë si mbështetje e si udhëheqje për të njohur natyrën e jetën shoqërore dhe për t'i shndërruar ato. Pra duke marrë parasysh se edhe vetë edukimi i fëmijës bazohet në të dhëna shkencore nga fusha të ndryshme e sidomos nga psikologjia dhe pedagogjia, e që për qëllim kanë përgatitjen e fëmijës për jetën, grupet shoqërore, nuk mund të funksionojë si proces pa përdorur metoda që përcaktojnë një qëllim dhe mjetet që përdoren për të arritur atë nga ana e të rriturve e që janë pozitive dhe të përshtatshme në edukimin e fëmijës pa e cenuar pavarësimin e tij. Por cilat janë metodatat me efikasë për të arritur qëllimet e paracaktuara dhe për edukimin e drejtë të fëmijës. Meqë flasim për edukimin në familje atëherë nuk mund të përmendim metoda dhe mjete të cilat me shumë i përcakton shkolla, mësuesit dhe që zbatohen pikërisht në një edukim në komunitet më të gjerë të fëmijëve dhe me qëllime që janë pak me të ndryshme sesa ato të familjes (Dolito, 2001).

Nëse flasim për metodatat dhe mjetet në familje me poshtë do të përmendim disa si me të rëndësishmet për mirëqenien dhe mirërritjen e fëmijës brenda familjes.

1.6.1. Trajtimi i fëmijëve me respekt

Janë të pakta ato raste në shoqërinë tonë kur prindërit, mësuesit apo ndonjë person i rritur i trajtojnë fëmijët e tyre me respekt dhe komunikojnë me ta sikur me një të rritur i cili gëzon

arsyen e gjërave dhe vetëdijen e plotë të veprimeve, gjë e cila duhet të bëhet edhe pse janë përballë një fëmijë. Mënyra se si u flasim fëmijëve tregon edhe për veten tonë dhe po ashtu edhe për ndikimin dhe shembullin që ata marrin e që do ta përdorin në të ardhmen karshi të tjerëve. Jo rrallë në mënyrë të qëllimshme ose jo fjalët që u drejtojmë fëmijëve si qëllim edukues, tingëllojnë urdhërore si psh., futu në makinë, pastroj dhëmbët, haje drekën etj. Në një moment tjetër presim nga ata që në raste të caktuara të jenë të mësuar të thonë të lutem, faleminderit, a mundem etj., dhe kjo ndodh më së shumti në pritshmërinë e prindërve. Tani këtu lehtë mund të vërehet se ku qëndron problemi në mungesën e shprehjeve të mira nga ana e fëmijëve, pra ata nuk patën një shembull të dëgjuar apo të parë për të përdorur fjalë të tilla (Boere, 2004).

Pse fëmijët janë të supozuar të bëjnë atë që ne ju themi? Në anën tjetër këtë nuk mund ta kërkojmë nga një i rritur dhe kjo tregon një mungesë respekti për fëmijën dhe qenien e tij. Fëmijët tuaj meritojnë respekt, po sigurisht, e thjeshtë sepse edhe ata janë qenie njerëzore. Por fillimisht ju nuk mund të merrni respekt nga ata nëse nuk e shprehni atë (Templar, 2013). një nder rregullat e thëna nga autori R. Templar në librin e tij “The rules of Parenting” e që theksohet shumë respekti i prindit ndaj fëmijës është Treat your Child with respect. Ai nder të tjera shton “ Nëse ju i doni fëmijët tuaj më shumë se çdo kënd tjetër (përveç bashkëshortit/ës tuaj) atëherë ata meritojnë respekt më shumë se çdokush tjetër dhe jo më pak (Garuli, 2017).

Në përgjithësi në edukimin e fëmijëve në familje është me rëndësi të përcaktosh qëllimin dhe pastaj metodën e mjetin për të arritur atë qëllim që ke me fëmijën dhe në fund të presësh përmbajtjen, rezultatin. Nëse nuk përcaktojmë qëllim nuk kemi as se si ta përdorim metodën apo mjetin edukues drejt tij (Hoti, 2012).

1.6.2. Mësimi përmes shembujve

Siç e dimë nga shumë autore të cilën na kanë dhënë opinione për zhvillimin dhe edukimin e fëmijëve, ajo e cila më së shumti ka ndikim është shembulli të cilin ata shohin tek ne. Duke marrë parasysh se fëmijët në periudhën e hershme mësojnë më së shumti përmes konkretizimit, ajo çfarë në bëjmë karshi tyre ose në prezencën e tyre është gjeja më konkrete që ata shohin dhe shembulli më i afërt (Gjika, 2018).

Një shembull sipas Dr. Montessori “ njëherë pash një fëmijë rreth 2 vjeç i cili vendosi një palë këpucë të zhytura një mbulese të bardhe shtrati. Me impulsivitet dhe pa menduar

shumë, unë morra ato këpucë i vendosa në një qoshe të dhomës dhe thash: “Ato janë të papastra”. Pastaj pastrova çarçafin me duar vendin ku ishin këpucët. Pas këtij incidenti, shoku i vogël, sa herë që shihte një palë këpucë, vraponte drejt tyre dhe thoshte “ Ato janë të papastra”. Pastaj do të shkonte afër shtratit ta vendoste dorën aty dhe të bënte sikur po pastron edhe pse këpucët as që ishin fare aty afër (Montesori, 2009) .

Pra fëmijët nuk arrijnë të kuptojnë qëllimin që ne kemi përcaktuar nëse nuk përdorim mënyrën e duhur për tu shfaqur pranë tyre. Edhe nëse enë këtë rast qëllimi ishte që fëmija të mbahej pastër apo që të edukohej të mos vendoste këpucë në çarçafin bardhe mënyra e veprimit nga personi i rritur ishte shembull konkret i cili më pas ndiqej nga fëmija pikërisht në mënyrën se si është parë.

1.6.3. Dashuria për ambientin që e rrethon

Qenia njerëzore është e prirë të kujdeset për ambientin rrethi tij. Nëse mendojmë për ambientin që e rrethon një fëmijë, përfshirë edhe familjen Prindërit apo motrat sepse edhe personat fizik janë pjese përbërëse e ambientit për një fëmijë, duhet të kemi parasysh që të jetë sa më i përshtatshëm për edukimin e fëmijës.

Fëmijët mësojnë shkathësinë e jetës dhe veprimit në atë ambient ku për herë të parë ekspozohen. Gjithashtu është e pashmangshme mënyra e sjelljes se të rriturve, Prindërve me të. Qetësia në shtëpi, lëvizjet e lehta dhe të buta në ambientet e shtëpisë e po ashtu në raport me fëmijën krijojnë një qetësi edhe tek i vogli. Nëse i rrituri vepron qetësisht, kujdeset me qetësi për gjerat në ambient, i vogli i cili është duke shikuar që të veprojë njësoj.

Marrëdhënia e të rriturve padyshim se ndikon edhe tek fëmijët. çdo i rritur - prind ka mënyrën dhe menaxhimin si prind për rritjen dhe edukimin e fëmijës dhe kjo duhet të jetë në përshtatje me emocionet e tij. Pra një ndje një e mire për rritjen e fëmijës, për zhvillimin e tij, për hapat e zhvillimit në të cilët kalon, të gjitha këto nuk duhet të shihen vetëm si obligime ndaj një të vogli por një kënaqësi e veprimit sepse fëmija do ta ndjeje edhe këtë pjese nga Prindërit sikurse edhe do ta ndjeje momentin kur ju i qaseni me nervozizëm apo të stresuar. “ Në fund të fundit disponimi juaj është po aq i rëndësishëm sa strategjia e rritjes se fëmijës dhe mënyra si jetoni si familje, apo është më shumë. Mos lejoni askënd t’ju bëjë të ndiheni me faj për veprimin tuaj, mënyrën se si veproni. Nëse ajo ju bën të ndiheni më rehat dhe më pak të stresuar, ndoshta mund të jetë mënyra më mire, cilado qoftë ajo (Templar, 2013).

1.6.4. Roli i mikro-mjedisit dhe i makro-mjedisit në edukimin e drejtë të fëmijës

Mikro-mjedisi përfaqëson ato rrethana dhe kushte konkrete në të cilat fëmijët, adoleshentët dhe të rinjtë sillen ditë për ditë, kalojnë sidomos një pjesë të kohës së lire. Këto mjedise i ndeshim kudo, si në krye të ndo një rrugice, në sheshe, në oborr, nën strehën e ndonjë pallati, në qendrën e bilardos, në afërsi të dyqaneve, në oborrin e shkollës, në rrugë, në varësi të lagjeve të vjetra dhe tradicionale të qytetit, në një shesh fshati, tek furra, klubi, fusha e lojës etj. (Kraja, 2002).

Pra siç e shohim mikro-mjedisi është një ambient i çfarëdoshëm ku ekspozohet një fëmijë dhe që rrjedhimisht po ai ambient ka ndikim tek edukimi dhe formimi i atij fëmije.

Këtu nuk ka strategji edukimi, pasi gjithçka zhvillohet sipas rastit. (Kraja, 2002). Pavarësisht kësaj që edukimi ndodh rastësisht, nuk duhet lejuar që të jetë një liri e tepruar e fëmijëve, pra prindërit duhet domosdo që të kenë një dorë kontrolli mbi makro-mjedisin e tyre dhe mikro-mjedisin ku fëmija ekspozohet në kohën e tij të lirë, kujdes i shtuar duhet të jetë veçanërisht atëherë kur në këto mjedise mund të ketë edhe efekt dhe gjera negative në edukimin e fëmijëve.

Mikro-mjedisi ndikohet fuqishëm nga makro-mjedisi. A.Tamo shkruan se në nivele makro e mikro-sociale, individët ndikojnë mbi të tjerët, si dhe ndikohen nga ata. Pra, në këto nivele është karakteristike prania e ndikimeve shoqërore. Këto mund të jenë të qëllimshëm dhe rastësore, të dukshme ose të padukshme, të drejtpërdrejta ose tërthore. (Kraja2002).

Siç edhe e dimë edukimi i qëllimshëm gjithmonë shkon krahas edukimit institucional, të organizuar pra ai edukim që përfshin shkollat dhe institucionet arsimore, qoftë ai edukim për njohuri akademike apo sociale. Në institucione të ndryshme edukativo arsimore e edhe kulturore ku grupe apo individ marrin njohuri të caktuara, jo gjithmonë të gjithë pëlqejnë apo pajtohet me atë që ju ofrohet. Ky edukim jo domosdo mund të ketë efekte pozitive edhe pse qëllimi gjithmonë është për një të mirë të shoqërisë, mund të ketë faktor negative në raste të caktuara në individ të caktuar, sidomos nëse flasim për grupe dhe jo gjithmonë për shkollën si institucion edukimi.

Ndikimi makro dhe mikro-social mbi individët dhe grupet e tyre karakterizohet, në mjaft raste nga mbështetja e institucionit shkollor, ashtu edhe siç mund t'i kundërvihet në disa drejtime, duke e penguar punën e tyre. për ta kapërcyer ndikimin negativ të faktorëve mikro-

social dhe për harmonizimin e këtij ndikimi me atë të institucioneve të posaçme edukative, janë paraqitur dy alternativa.

1. Pedagogjizmi i faktorëve makro e mikro-social;
2. Aftësimi i institucionit shkollor për të kryer një funksion të spikatur social-pedagogjik.

Kjo do të thotë që të vihen mbi baza pedagogjike veprimi mbi faktorët makro dhe mikro-socialë, duke mbetur i tillë, të mbështetur edhe mbi faktorët pedagogjike, të dhënat e shkencës pedagogjike. (Kraja 2002).

Duke marrë parasysh që fëmijët nuk mund të qëndrojnë të izoluar dhe domosdo do të qëndrojnë në një mjedis makro ose mikro-social, kur aty ka faktorë pedagogjikë fëmija do të merrte një edukim pozitiv edhe në kohën e tij të lirë.

1.7. Parakushtet për edukim të suksesshëm

Edukimi për Jetën Familjare është praktika profesionale e pajisjes dhe fuqizimit të anëtarëve të familjes për të zhvilluar njohuri dhe aftësi që rrisin mirëqenien dhe forcojnë marrëdhëniet ndër personale përmes një qasje arsimore dhe të bazuar në pikat e forta. Aftësitë dhe njohuritë e nevojshme për funksionimin e shëndetshëm të familjes janë të njohura gjerësisht si aftësi komunikimi dhe marrëdhënie të shëndetshme ndërpersonale në mes të anëtareve të familjes e në veçanti të prindërve, çiftit të cilët mendojnë dhe vendosin të krijojnë një familje të përbashkët (Jefte, Moffit, Casipi, & Taylor, 2003).

Praktikat e përditshme familjare përqafojnë pozicionimin shoqëror dhe kulturor, si dhe burimet shoqërore dhe kulturore. Prindërimi përfshin pritjet prindërore, praktikat prindërore në lidhje me shkollimin e fëmijëve të tyre dhe përfaqësimet e aftësive të fëmijëve të tyre (Kazmo, Thenasi, & Iliazi, 2012).

Nivelet arsimore të prindërve ndikojnë pozitivisht në edukimin e menjëhershëm të fëmijëve të tyre rezultatet dhe arritjet arsimore dhe profesionale në moshën e rritur të mesme (Dubow, Boxer, & Huesmann, 2009).

Fëmijët mësojnë duke vëzhguar ata që janë përreth tyre dhe përmes përvojave të drejtpërdrejta. Sjelljet e tyre formohen më pas nga këto ndërveprime (Bandura siç citohet në

Dubow et al.,2009). Investimi i kohës së prindërve në një fëmijë të vogël është një nga parashikuesit kryesorë të një fëmije suksesi si i rritur. Nënata e arsimuara në kolegji kalojnë më shumë kohë sigurimi i kujdesit për fëmijët dhe veprimtarive të përshtatshme për moshën me fëmijët e tyre sesa nënat të cilët kanë një arsim të shkollës së mesme (Kalil, Ryan, & Corey, 2012).

1.7.1. Zgjedhja e partnerit (martesa) si parakusht për edukimin e suksesshëm të fëmijëve

Fillimisht zgjedhja e partnerit bëhet në baze të disa kushteve varësisht nga parimet e secilit individ. Në një shoqëri ku dominon një kulturë dhe edukim më i avancuar tek të rinjtë, zgjedhjen e partnerit e bëjnë në bazë të disa parimeve të jetës dhe jo vetëm mbi dashurinë pa parime e pa kushte, e cila ndodh edhe të jetë e qëndrueshme, mirëpo ndodh edhe të jetë afatshkurtër e po ashtu edhe jo e frytshme në krijimin e një familjeje.

Nëse një i ri apo e re zgjedh të krijojë familje në një moshe të caktuar, zgjedhja e partnerit duhet të ndërtohet në baze të disa parimeve themelore të cilat i paraprijnë krijimit të familjes. Nëse të dy partneret kanë qëllim të përbashkët lindjen e fëmijëve, zhvillimin dhe edukimin e tyre, harmonizimin e jetës së përbashkët në një familje si qift dhe si Prindër, duhet të kenë parakushtet dhe qëllimet e tyre të përbashkëta. Ideja për rritjen e fëmijëve duhet të jetë e ngjashme, qëllimi dhe pikat mbështetëse drejt rrugëtimit duhet të jenë po ashtu të ngjashme në mënyrë që të mos hasin probleme e pengesa pastaj gjatë jetës së tyre por të përqendrohen në zhvillimin e fëmijëve dhe rolin e tyre si Prindër.

Martesa dhe prindërimi janë të lidhura ngushtë, pothuajse të ndërvarura. Një marrëdhënie e mirë me partnerin mund të bëjë prindër të mirë dhe një ekuacion i shëndetshëm i prindërve mund të ketë një ndikim pozitiv në rritjen mirëqenien e po ashtu edhe martesën e qiftit. Lejoni që dashuria mes jush dhe partnerit tuaj të shndërrohet në një partneritet të bukur për prindërim. Lëreni gëzimin dhe gëzimin e një fëmije të derdhet në martesën tuaj. (“Parentin advice”)

1.8. Teoritë e personalitetit

1.8.1. Teoria psikoanalitike e Freud (Frojdit)

Teoria e personalitetit e Frojdit përbëhet nga tre koncepte kryesore: id-i, superego dhe ego. Idi, që është i pranishëm që në lindje, përfaqëson prirjet bazë instiktive dhe biologjike. Frojdi pretendonte se idi vepron mbi bazën e parimit të kënaqësisë në të cilin prirjet (nxitjet) instiktive kërkojnë kënaqësi të menjëhershme në mënyrë të pandërgjegjshme dhe impulsive, duke mos marrë parasysh gjë tjetër (Freud S. , 1958).

Sipas Frojdit, energjia psikike, ose libido, shtyn idin. Idi përmban dy instinkte kryesore: instinkti i jetës dhe instinkti i vdekjes. Instinkti i jetës, ose erosi ndihmon individët dhe speciet që të mbijetojnë. Seksi është shprehja kryesore e instinktit të jetës dhe është motivacion për një llojshmëri të madhe të mendimeve dhe sjelljeve njerëzore. Frojdi sugjeroi se libido është në pjesën më të madhe energji seksuale që motivon erosin. Erosi nuk kufizohet me motivacionin e drejtpërdrejt seksual, por besohet të jetë pjesë e çdo aktiviteti kënaqësi sjellës. Instinkti i vdekjes ose thanatos, përfshin agresivitetin dhe shkatërrimin. Frojdi nuk e zhvilloi konceptin e instinktit të vdekjes në mënyrë aq të plotë sa instinktin e jetës. (Freud S. , 1958).

Superego përbëhet nga vlera shoqërore dhe familjare që i janë ushqyer personit. Ajo është në një masë të madhe e pandërgjegjshme dhe frenon dëshirat e idit. Ajo përfaqëson aspektet morale të një personi dhe është më shumë idealiste se realiste. Pra superego përfshin ndërgjegjen (njohuri për sjelljet e gabuara) dhe idealin e egos (njohuri për sjelljet e drejta) (Freud S. , 1958).

Ego përbëhet nga një aftësi e ndërgjegjshme për të perceptuar dhe për tu marrë me realitetin në mënyrë inteligjente. Ajo vepron si ndërmjetës midis idit (duke i larguar dëshirat për kënaqësi të menjëhershme) dhe superegos (duke pranuar se disa nga forcat penguese të saj nuk janë racionale). Ego vepron në bazën e parimit të realitetit dhe përpiket të gjej mënyra të pranueshme nga shoqëria (sipas superegos) për të kënaqur idin. Në personalitetin e një personi të përshtatur mirë ego është forca dominante (Freud S. , 1958).

Sipas Frojdit personaliteti i një individi është rezultat i ndërveprimit të këtyre tre forcave. Në njëfarë mënyre idi përfaqëson "dua", superego "duhet" dhe ego "mund". Idi që është më shumë i pandërgjegjshëm dhe racional, shprehet në mënyrë kognitive. Kur të tre strukturat e

personalitetit ndërveprojnë kjo mund të çojë edhe në konflikt.P.sh.,idi kërkon kënaqësi të menjëhershme, kurse ego është e aftë të presë (Freud S. , 1958).

1.8.2. Teoria analitike e Karl Jungut

Një nga kolegët e Frojdit-Karl Jung,do ta bënte eksplorimin e kësaj hapësire të brendshme, veprën e jetës së tij. Nëse gjendet dikush që mund të kuptoj të pavetëdijshmen dhe natyrën e saj të zbulimit të vetvetes vetë në formë simbolike, do të ishte Karl Jung. Ai jo vetëm që mori si të mirëqenë pavetëdijen, ku gjërat nuk janë lehtësisht të mundshme për syrin empirik, por mori si të mirëqenë “pavetëdijen kolektive”,që kurrë s’ka qenë dhe kurrë nuk do të jetë vetëdije. Jung fillon me nivelet më të larta, madje me spiritualizmin dhe përfitoi nivelet e ulëta të psikologjisë dhe fiziologjisë. Ai ka nxjerr në pah që të rriturit kërkojnë më shumë integrimin, trashedencën e të kundërtave. Kjo teori përbëhet jo vetëm nga e ndërgegjegjshmja personale, edhe nga e pandërgjegjshmja kolektive (që përbëhet nga arkitipat) që janë të përbashkëta për gjithë njerëzimin. Qëllimi i personalitetit të shëndoshë është të arrijë individualizimin, në të cilën të gjitha pjesët e personalitetit janë të zhvilluara në mënyrë të plotë dhe të integruara në mënyrë harmonike. Jungu besonte se energjia e libidos mund të drejtohet së jashtmi(ekstraversioni) dhe së brendshmi (intraversioni). Jungu identifikoi 8 tipa psikologjike të personalitetit (Kraja, 2005).

1.8.2. Teoria individuale e personalitetit e Alfred Adlerit

Kjo teori thotë se njerëzit motivohen kryesisht nga një nxitje për superioritet, duke përpjekur të kapërcejnë një sens dobësie. Gjithashtu, e rëndësishme në këtë teori është interesi shoqëror i njerëzve, aftësia për të dashur të tjerët dhe për të kooperuar për qëllime shoqërore (Adler, 1978).

1.8.5. Teoria e Gordon Allport

Kjo teori ka të bëjë me funksionimi oportunist-si tendenca për të kënaqur nevojat e mbijetesës biologjike. Ky funksionim, mund të karakterizohet si reaktiv, i orientuar në të kaluarën dhe biologjik. Por Allport mendonte se ky funksionim nuk mjaftonte për të kuptuar sjelljen njerëzore, sipas tij sjellja njerëzore motivohet nga diçka shumë e ndryshme – duke funksionuar në mënyrën e shprehjes së unit- të cilën ai e quajti funksionim i përshtatshëm -të bërit e gjërave në harmoni me çfarë jeni në të vërtetë. Sipas Allport, uni përbëhet nga aspekte të eksperiencave që i shohim si më thelbësore. Uni ka shtatë funksione që tentojnë të shfaqen në periudha të ndryshme të jetës:

1. Gjykimi i trupit- në dy vitet e para...intimiteti...pështyma

2. Identiteti i unit- në dy vitet e para të jetës...dje-sot..
3. Vetëbesimi-në dy-katër vjeç, njohim vlerën...vetes ..tjerëve..
4. Zgjerimi i unit- katër-gjashtë vjeç, çka ndodh përreth bëhet e rëndësishme për ekzistencën-imja është më afër se mua .
5. Imazhi i unit – katër-gjashtë vjeç, si më shikojnë të tjerët mua-fillimi i vetëdijes-unit ideal dhe personalitetit.
6. Përballja racionale- gjashtë – 20 vjeç...
7. Përpjekjet e përshtatshme – 20 e tutje, uni si synim, ideal, plane, profesion, qëllim...kulmi i përpjekjeve të duhura është aftësia për të thënë që jam zot i jetës sime (Macfarlane, 2004).

1.8.6. Teoria e Erich From

Karakterit tërheqës, i teorisë së tij qëndron në atë që i përvishet problemit, të personalitetit, nga një aspekt, i gjerë, duke marrë parasysh, përveç momenteve psikologjike, dhe ato sociologjike, e filozofike-etike, duke shfrytëzuar me atë rast shumë konstatime, dhe supozime të Marksit. Botëkuptimin e vet mbi personalitetin, Fromm e shpjegon në veprën e vet, ‘‘Arratia nga Liria’’. Fromi, thekson se ndjenja themelore, e njeriut i cili rronte nëpër formacionet, tashme të njohura, shoqërore, sistemin (skllavopronar, feudal, kapitalist). Ndjenja e vetmisë dhe e izolimit, ndjenja e vetmisë dhe frikës, kushtëzohet me ndarjen e njeriut prej natyrës. Një gjë e tillë nuk ndodh në asnjë prej qenieve të gjalla. Njeriu gjatë zhvillimit shoqëror, fiton njëfarë lirie. Mirëpo njëkohësisht, vjen e rritet ndjenja e tij e vetmisë, sepse liria, të cilën e fiton, s’është liria e mirëfilltë, bie fjala prej sistemit skllavopronar, në at feudal, skllavi fiton më shumë të drejta sesa që kishte më parë, mirëpo hyn në një botë, të cilën e kishte me të huaj, në të cilën ishte më tepër vetëm dhe më shumë i ndarë prej të tjerëve. Sa ishte skllav sado që ishte më pak i lirë, ishte në një mënyrë, të caktuar më shumë i lidhur me njerëzit. E njëjta ndodh edhe me njerëzit, psh., fëmija sa është i vogël është gjithmonë i lidhur me njerëzit, sidomos me prindërit, por duke u rritur, bëhet më i pavarur por më pak i sigurt, ndien vetminë e vet. Dmth, sipas Fromit, nevojat njerëzore janë pesë: Nevoja e parë është nevoja për lidhni. Duke e tejkalluar, shtazën njeriu e humbi lidhjen me natyrën, ai kërkon një lidhje tjetër, ai kërkon lidhni që i përgjigjet natyrës së tij

njerëzore, e kjo është dashuria prodhuese siç thotë Fromi, e cila e lidhe njeriun me natyrën e tij shoqërore, që manifestohet me kujdes reciprok, dhe mirëkuptim reciprok mes njerëzve (Macfarlane, 2004).

Nevoja e dytë- kalimi i natyrës së vet shtazore, në atë që të bëhet person krijues, krijesë në natyrë.

Nevoja e tretë,- është që të bëhet një personalitet konkret, një person i caktuar dhe i veçantë, që të ketë identitetin e vet, që të ketë ndjenjën e unitetit personal. Pra, d.m.th njeriu duhet ta gjej vendin e tij dhe vlerën e tij në botë me nevoja të shumta, të jetë i mirëpritur dhe i respektuar nga shoqëria, dhe nevoja e fundit, është që njeriu ta ketë orientimin themelor, në mënyrë të përhershme perceptimi, të kuptuari dhe shpjegimi mbi botën. Pra personalitetin mund ta kuptojmë vetëm atëherë nëse e njohim sistemin e caktuar vlerën tonë, në rrethe të ndryshme shoqërore si dhe dominimin tonë (Macfarlane, 2004).

KAPITULLI II

METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

2.1. Objekti i hulumtimit

Objekti kryesor i këtij hulumtimi ka qenë familja, zgjedhja e partnerit për jetë të përbashkët, krijimi i saj, rritja dhe edukimi i fëmijëve, ndikimi i familjes dhe ambientit të saj në formimin e personalitetit të fëmijës si dhe mendimet e fëmijëve më të rritur për familjen dhe ndikimin që ajo ka ose ka pasur në personalitetin e tyre. Sa ka ndikuar familja në personalitetin të një fëmije të pavarur dhe të gatshëm për jetën. Rol me rëndësi në formimin e personalitetit ka ambienti në të cilin lind dhe rritet fëmija. Sa më i përshtatshëm që është ky ambient, edukues dhe me kulturë pedagogjike, padyshim se fëmija do të jetë një personalitet i pëlqyeshëm dhe i suksesshëm në shoqërinë e së ardhmes. Këto procese janë indikator të fuqishëm që kanë dhënë shtytje për të zhvilluar një hulumtim lidhur me këto çështje.

2.2. Qëllimi i hulumtimit

Qëllimi i këtij hulumtimi ka qenë të kontribuoj në fushën e edukimit, formimin e personalitetit të fëmijës, ndikimet gjatë formimit në veçanti ambienti familjar, roli dhe rëndësia e tij, cilët janë faktorët kyç që ndikojnë pozitivisht apo negativisht gjatë formimit të personalitetit të fëmijës. Hulumtimi është bërë me gjithsej 120 familje përfshirë prindërit, fëmijët dhe anëtarët e tjerë të familjes, dhe pjesa tjetër përfshin 150 fëmijë 12 deri në 18 vjeç. Hulumtimi është bërë në qytetin e Prishtinës.

2.3. Detyrat e hulumtimit

Detyrat e studimit tonë janë:

- Të shqyrtojmë në literaturën teorike ekzistuese për të kuptuar më thellë problemin dhe për të parë lidhjen midis studimit tonë dhe studimeve të tjera të realizuara.
- Të identifikohet dhe përcaktohet ndikimi i ambientit familjar në formimin e personalitetit të fëmijës.

- Të ofrojë rekomandime dhe këshilla me qëllim për të ardhur në ndihmë familje prindërve dhe fëmijëve në këtë fushë.

2.4. Metodatat dhe teknikat e hulumtimit

Për realizimin e këtij studimi u përdor metoda kuantitative (sasiore) e studimit. Ku përmes kësaj metode përcaktohet ndikimi i ambientit familjar në formimin e personalitetit tek fëmijët. Kërkimi kuantitativ, siguron disa përparësi krahasuar me alternativat e tjera të kërkimit dhe besoj ka realizuar më së miri qëllimin e studimit. Përparësia kryesore e kërkimit kuantitativ qëndron në faktin se ai siguron një kuptueshmëri më të thellë të popullatës në studim (Meriac, 2012).

2.5. Pyetjet e hulumtimit dhe hipoteza

- Çfarë ndikimi ka ambientit familjar në formimin e personalitetit të fëmijës?

Hipoteza

- Ambienti familjar mund të ketë rol pozitiv në formimin e personalitetit të fëmijës.

Pyetjet hulumtuese

- Cilët janë faktorët më me ndikimin në formimin e personalitetit të fëmijës?
- Si ndikon raporti ndërprindëror në formimin e personalitetit të fëmijës?
- Çfarë e bën një familje që të ketë një ambient edukues për rritjen e fëmijës?
- Çfarë roli luan familja e gjerë në edukimin e fëmijës?

2.6. Instrumentet matëse

Instrumenti u përcaktua nga nevoja për të siguruar të dhëna në këndvështrime të ndryshme për ta bërë më kuptimplote krahasimin midis rezultateve të tyre. Për realizimin e hulumtimit tonë u përdoren dy instrumente matëse, njëri për prindërit dhe tjetri për fëmijët. Pyetësori

parë përveç të dhënave demografike ka 23 pyetje të mbyllura me shkallë të ndryshme vlerësuese, kurse në pyetësin e dytë për fëmijët kemi 8 pyetje të mbyllura me shkallë të ndryshme vlerësuese.

2.7. Popullacioni dhe mostra e hulumtimit

Popullacioni i këtij hulumtimi përfshin gjithsej 120 familje dhe 150 fëmijë të moshës 10-16 vjeç nga 198,214 numri banorëve në regjionin e Prishtinës regjistruar në vitin 2011.

Hulumtimi është bërë pa përfshirë zonat rurale

Mostra është përzgjedhur në mënyrë të qëllimshme dhe e rastësishme, ku janë përfshirë familje me numër të ndryshueshëm të anëtarëve, ndryshueshmëri në shkallën e pedagogjizmit të familjes, kulturë dhe zakone të ndryshme si dhe jetesë në kushte jo të njëjta ekonomike e sociale, ndërsa në përfshirjen e fëmijëve në hulumtim është përdorur mostra e rastësishme.

2.8. Organizimi i hulumtimit

Fillimisht kemi ndërtuar pyetësin në google formë për ta aplikuar online shkaku i çështjes aktuale të pandemisë. Në pyetësor është sqaruar se të dhënat do të jenë anonime dhe të dhënat do të përdoren vetëm për temë diplome. Pyetësi është plotësuar brenda 10 dite, kurse mostra ishte e rastësishme.

2.9. Përpunimi statistikor i të dhënave

Pas mbledhjes së fakteve në terren, vjen puna në tavolinë, që ka të bëjë me analizën dhe përpunimin e statistikave. Deklaratat e ndryshme kërkojnë analizë specifike për të gjetur treguesit që na interesojnë. Përpunimin i rezultateve është bërë me anë të programin SPSS25, i cili mundëson që të dhënat e futura në databazë të përpunohen më shpejt. Paraprakisht është përpiluar një skemë koduese të dhënash, në shprehje kuantifikuese. Kodimi i informatave është procesi i shndërrimit në një format të kuantifikuar, zakonisht numerik, që të mund të bëhet më lehtë analiza sistematike e tyre. Procesi i kodimit filloi me kodimin e përgjigjeve paraprakisht, duke mundësuar që numrat të rumbullakohen ose të shënuar të futen direkt në

bazë të të dhënave. Vlera e të dhënave si numra ose si emërtime varet nga analizat që është bërë. Analizat që janë bërë në këtë studim janë analizat deskriptive pastaj është përdorur analiza e korrelacionit të Pearsonit, Anoven dhe T-testin.

KAPITULLI III

REZULTATET E HULUMTIMIT

Nga mostra e qëllimshme e hulumtimit, nxjerrim rezultate se si ka ndikuar ambienti familjar, edukimi, kushtet, kultura dhe faktor të tjerë në formimin e personalitetit të fëmijës, sa dallojnë potencialet dhe formimi e zhvillimi i fëmijës në raport me ambientin ku janë rritur. Ndërsa nga hulumtimi me mostrën e rastësishme të fëmijët nxjerrim rezultate se si e shohin ata ndikimin e ambientit familjar në formimin e personalitetit të tyre.

Tabela 1. Paraqitja tabelare e numrit të fëmijëve dhe përqindja relative e tyre

		Frekuencat	Përqindja
Valid	1 fëmijë	48	35.6%
	2 fëmijë	49	36.3%
	3 fëmijë	26	19.3%
	Më shumë se 3 fëmijë	4	3.0%
	Më shumë se 4 fëmijë	1	.7%
	Total	128	94.8%
Missing	System	7	5.2%
Total		135	100.0%

Numri i fëmijëve- Tabela 1 na tregon se gjithsej në studim morën pjesë 128 prindër ku 35.6% e tyre kishin 1 fëmijë, 36.3% e prindërve kishin 2 fëmijë, 19.3% e prindërve kishin 3 fëmijë, 3.0% e tyre kishin më shumë se 3 fëmijë dhe 7% e prindërve kishin më shumë se 4 fëmijë.

Tabela 2. Paraqitja tabelare e arsimimit të prindërve dhe përqindja relative e tyre

		Frekuencat	Përqindja
Valid	Arsimi bazë	1	0.7%
	Arsimi i mesëm	12	8.9%
	Arsimi universitar	115	85.2%
	Total	128	94.8%
Missing	System	7	5.2%
Total		135	100.0%

Arsimimi i prindërve- Nga tabela 2 shohim se 0.7% e prindërve kishin kryer arsimin bazë, 8.9% e prindërve kanë kryer arsimimin e mesëm dhe 85.2% e kanë kryer arsimimin e mesëm.

Tabela 3. Planifikimi i familjes

		Frekuencat	Përqindja
Valid	E planifikuar	119	88.1%
	E pa planifikuar	9	6.7%
	Total	128	94.8%
Missing	System	7	5.2%
Total		135	100.0%

Planifikimi i familjes- Nga tabela 3 shohim se shumica e prindërve 88.1% e kanë planifikuar zgjerimin e familjes kurse 6.7% ka qenë e pa planifikuar.

Tabela 4. Paraqitja tabelare e moshës së fëmijëve dhe përqindja relative e tyre

		Frekuencat	Përqindja
Valid	Femër	36	26.7%
	Mashkull	24	17.8%
	Total	60	44.4%
Missing	System	75	55.6%
Total		135	100.0%

Gjinia e fëmijëve- Tabela 4 na tregon se gjithsej në studim morën pjesë 60 fëmijë ku 26.7% ishin të gjinisë femërore dhe 17.8% të gjinisë mashkullore. Pra këtu shohim se kemi një dominim të gjinisë femërore krahasuar me gjininë mashkullore

Tabela 5. Paraqitja tabelare e moshës së fëmijëve dhe përqindja relative e tyre

		Frekuencat	Përqindja
Valid	12-15	135	100%
Total		135	100.0%

Mosha e fëmijëve- Nga tabela 5 shohim se të gjithë fëmijët e anketuar ishin nga misha 12-15 vjet.

Tabela 6. Paraqitja tabelare e stileve të prindërimit dhe përqindja relative e tyre

		Frekuencat	Përqindja
Valid	Prind me autoritet (shumë dashuri, shumë kontroll)	100	74.1%
	Prind autoritar (pak dashuri, shumë kontroll)	1	0.7%
	Prind tolerant (shumë dashuri, pak kontroll)	26	19.3%
	Prind refuzues (pak dashuri, pak kontroll)	1	0.7%
	Total	128	94.8%

Missing	System	7	5.2%
Total		135	100.0%

Stilet e prindërimit- Nga tabela 6 shohim se shumica e prindërve 74.1% kanë stil të prindërimit autoritativ, 0.7% e prindërve kanë stil të prindërimit autoritativ, 19.3% e prindërve kanë stil të prindërimit tolerues dhe 0.7% e prindërve kanë stil të prindërimit refuzues.

Tabela 7. Të dhënat deskriptive për ambientin familjarë dhe personalitetin e fëmijëve

	N	Minimumi	Maksimumi	Mesatarja	Devijimi standard
Ambienti familjar	128	1.68	2.74	2.2796	.19823
Personaliteti i fëmijëve	60	1.33	3.50	2.6111	.63236
Valid N (listwise)	60				

Nga të dhënat e tabelës 7 shohim se minimumi i vlerësimit për ambientin familjar është 1.68 maksimumi 2.74, mesatarja 2.27 dhe devijimi standard 0.19.

Minimumi i vlerësimit të personalitetit tek fëmijët është 1.33, maksimumi 3.50, mesatarja 2.61 dhe devijimi standard 0.63.

Në hipotezën **H1** kemi paraqitur pohimin mbi ekzistimin e ndërlidhjes në mes ambientit familjar dhe personalitetit tek fëmijët

Më poshtë, në tabelën nr. 8 është paraqitur analiza e korrelacionit në mes ambientit familjar dhe personalitetit tek fëmijët

Tabela 8. Korrelacioni në mes ambientit familjar dhe persinalitetit tek fëmijët

		Ambienti familjar	Personaliteti i fëmijëve
Ambienti familjar	Pearson Correlation	1	.171
	Sig. (2-tailed)		.192
	N	128	60
Personaliteti i fëmijëve	Pearson Correlation	.171	1
	Sig. (2-tailed)	.192	
	N	60	60

Nga analiza korrelative nxjerrim këto përfundime: Ambienti familjar ka marrëdhënie lineare pozitive me personalitetin e fëmijëve $r=.171$. Signifikanca është .192. $p>0.05$ në nivelin e rëndësisë 0.05. Nga kjo mund të themi se nuk ka ndonjë lidhje signifikante në mes dy ndryshoreve.

Si përfundim mund të themi se nuk ka ndërlidhje signifikante në mes ambientit familjar dhe personalitetit të fëmijëve. Nga këto rezultate mund të përfundojmë se nuk e pranojmë hipotezën 1.

Më poshtë, në tabelën nr. 9 është paraqitur analiza e korrelacionit në mes ambientit familjar, personalitetit tek fëmijët dhe stileve të prindërimit.

Tabela 9. Korrelacioni në mes ambientit familjar, personalitetit të fëmijëve dhe stileve të prindërimit

		Ambienti familjar	Personaliteti i fëmijëve	Stilet e prindërimit
Ambienti	Pearson Correlation	1	.171	.071
	Sig. (2-tailed)		.192	.426
	N	128	60	128
Personaliteti	Pearson Correlation	.171	1	.061
	Sig. (2-tailed)	.192		.641
	N	60	60	60
Në cilin stil të prindërimit e shihni veten tuaj?	Pearson Correlation	.071	.061	1
	Sig. (2-tailed)	.426	.641	
	N	128	60	128

Nga analiza korrelative nxjerrim këto përfundime: Ambienti familjar ka marrëdhënie lineare pozitive me stilet e prindërimit $r=.071$. Signifikanca është .426. $p>0.05$ në nivelin e rëndësisë 0.05. Nga kjo mund të themi se nuk ka ndonjë lidhje signifikante në mes dy ndryshoreve.

Personaliteti i fëmijëve ka marrëdhënie lineare pozitive me stilet e prindërimit $r=.061$. Signifikanca është .641. $p>0.05$ në nivelin e rëndësisë 0.05. Nga kjo mund të themi se nuk ka ndonjë lidhje signifikante në mes dy ndryshoreve.

Në hipotezën **H2** kemi paraqitur pohimin mbi dallimet e stileve të prindërimit

Tabela 10. Të dhënat deskriptive të stileve të prindërimit me ambientin familjar

	N	Mesatarja	Devijimi standard
Prind me autoritet (shumë dashuri, shumë kontroll)	100	2.2737	.19450
Prind autoritarist (pak dashuri, shumë kontroll)	1	2.1053	.
Prind tolerues (shumë dashuri, pak kontroll)	26	2.3036	.21691
Prind refuzues (pak dashuri, pak kontroll)	1	2.4211	.
Total	128	2.2796	.19823

Tabela 11. ANOVA për stilet e prindërimit në kontekst të ambientit familjar

Ambienti

	Shuma e katrorëve	Df (Shkallët e lirs)	Mesatarja e katrorëve	F	Sig.
Ndërmjet grupeve	.069	3	.023	.579	.630
Brenda grupeve	4.921	124	.040		
Total	4.990	127			

Rezultatet nga analiza njëkahëshe e variancës (ANOVA) tregojnë se nuk ka dallime signifikante ($p > 0.05$) në mes ambientit familjar dhe stileve të prindërimit për të gjitha shkallët ku $F(127)=579$, $p > 0.05$. Ku prindi autoritet ka ($M=2.27$ dhe $Ds= 0.19$), prindi autoritar ka ($M=2.10$), prindi ka ($M= 2.3$ dhe $Ds=0.2$) dhe prindi refuzues ($M=2.4$). Pra nga rezultatet del se

nuk ka rëndësi signifikante në mes në mes ambientit familjar dhe stileve të prindërimit për të gjitha shkallët nga këto rezultate themi se nuk e aprovojmë hipotezën 2.

Në hipotezën **H3** kemi paraqitur pohimin mbi dallimet e planifikimit dhe mos planifikimit familjar në kontekst të ambientit familjar

Tabela 12. Dallimet në mes planifikimit dhe mos planifikimit familjar në kontekst të ambientit familjar

	Gjinia	N	Mesatarja	Devijimi standard	Mesatarja e gabimit standard
Ambienti familjar	Familje planifikuar	119	2.2769	0.19603	0.01797
	Familje e pa planifikuar	9	2.3158	0.23538	0.07846

Tabela 13. Dallimet në mes planifikimit dhe mos planifikimit familjar në kontekst të ambientit familjar përmes T-testit

		Testi i Leventit për barazimin e variaces		t-testi për barazimin e mesatareve						
		F	Sig.	T	df	Sig. (2-tailed)	Mesatarja e diferencave	Diferenca e gabimit standard	95% Diferenca e intervalit të besueshmërisë	
									E ulët	E lartë
Ambienti familjar	Varianca të barabarta të supozuara	1.277	.261	-.566	126	.572	-.03892	.06871	-.17490	.09706
	Varianca të barabrta jo të supozuara			-.484	8.860	.640	-.03892	.08049	-.22144	.14360

Duke i vështruar mesataret që arrijnë familjet e planifikuara dhe ato të pa planifikuara në tabelën 12 dhe 13 shohim se familjet e planifikuara arrin mesatare të ambientit familjar ($M=2.27$ dhe $Ds=0.19$) kurse familjet e pa planifikuara kanë mesatare të ambientit familjare ($M=2.31$ dhe $Ds= 0.23$) Signifikanca është 0.572 . $p>0.05$ në nivelin e rëndësisë 0.05 . Nga kjo mund të themi se ekzistojnë dallime të vogla ndërmjet familjeve të planifikuara dhe ato të pa planifikuara por nuk ka ndonjë rëndësi signifikante nga këto rezultate themi se nuk e pranojmë hipotezën 3.

Në hipotezën **H4** kemi paraqitur pohimin mbi dallimet e gjinore në kontekst të personalitetit të fëmijëve

Tabela 14. Paraqitja tabelare e dallimeve gjinore në kontekst të personalitetit të fëmijëve

	Gjinia	N	Mesatarja	Devijimi standard	Mesatarja e gabimit standard
Personaliteti i fëmijëve	Femër	36	2.4815	0.63593	0.10599
	Mashkull	24	2.8056	0.58703	0.11983

Tabela 15. Paraqitja tabelare e dallimeve gjinore në kontekst të personalitetit të fëmijëve përmes

T-testit

		Testi i Leventit për barazinë e variancës		t-testt për barazimin e mesatareve						
		F	Sig.	t	df	Sig. (2-tailed)	Mesatarja e diferencave	Diferenca e gabimit standard	95% Diferenca e intervalit të besueshmërisë	
									E ulët	E lartë
Personaliteti i fëmijëve	Varianca të barabarta të supozuara	1.047	.310	-1.99	58	.051	-.32407	.16259	-.64954	.00139
	Varianca të barabarta jo të supozuara			-2.02	52.107	.048	-.32407	.15998	-.64507	-.00308

Duke i vështruar mesataret që arrijnë femrat dhe meshkujt në tabelën 14 dhe 15 shohim se femrat arrin mesatare (M=2.48 dhe Ds=0.63) kurse meshkujt kanë mesatare (M=2.80 dhe Ds=0.58) Signifikanca është 0.51. $p > 0.05$ në nivelin e rëndësisë 0.05. Nga kjo mund të themi se ekzistojnë dallime të vogla gjinore në kontekst të personalitetit të fëmijëve por nuk ka ndonjë rëndësi signifikante nga këto rezultate themi se nuk e pranojmë hipotezën 4.

KAPITULLI IV

DISKUTIMET

Në këtë kapitull janë përmbledhur gjetjet kryesore të studimit duke i diskutuar ato në lidhje me literaturën përkatëse. Këto gjetje janë krahasuar me studime të tjera nga autorë të ndryshëm dhe është paraqitur këndvështrimi lidhur me to ku është kryer edhe ky studim.

Diskutime për hipotezën H1: është paraqitur pohimin mbi ekzistimin e ndërlidhjes në mes ambientit familjar dhe personalitetit tek fëmijët

Për ta parë ndërlidhjen në mes ambientit familjar dhe personalitetit tek fëmijët është përdorur analiza e korrelacionit. Nga analiza korrelative në studim janë nxjerrë këto përfundime: Ambienti familjar ka marrëdhënie lineare pozitive me personalitetin e fëmijëve. Nga kjo mund të themi se nuk ka ndonjë lidhje signifikante në mes dy ndryshoreve. Si përfundim mund të themi se nuk ka ndërlidhje signifikante në mes ambientit familjar dhe personalitetit të fëmijëve. Nga këto rezultate mund të përfundojmë se nuk e pranojmë hipotezën 1.

Lidhjet midis dimensioneve të këtij niveli janë të ngjashme me ato që raportohen nga studimet ndërkombëtare (Kulkarni, Fareill, Erasi, & Koschar, 1998) edhe pse koeficienti i korrelacionit të ambientit familjar me personalitetin e fëmijëve nuk është signifikant. Për shembull, në një studim ndërkombëtar dimensionet e lidhur më fort me njëri-tjetrin ambientit familjar dhe personalitetit të fëmijëve (Spearman's $\rho=0.63$) (Kulkarni, Fareill, Erasi, & Koschar, 1998), kurse në këtë studim ndërlidhja mes ambientit familjar dhe personalitetit të fëmijëve ishte (Pearson's -0.171 dhe sginikanca 192).

Diskurime për hipotezën H2: është paraqitur pohimin mbi dallimet e stileve të prindërimit në ambientin familjar

Për të parë dallimet nëse ekzistojnë apo jo dallime tek stilet e prindërimit kemi aplikuar analizën ANOVA. Rezultatet nga analiza njëkahore e variancës (ANOVA) tregojnë se nuk ka dallime signifikante ($p>05$) në mes ambientit familjar dhe stileve të prindërimit për të gjitha stilet e prindërimit. Pra nga rezultatet del se nuk ka rëndësi signifikante në mes në mes ambientit familjar dhe stileve të prindërimit për të gjitha stilet e prindërimit nga këto rezultate themi se nuk e aprovojmë hipotezën 2.

Arsyeja pse ka dalë rezultati i tillë është sepse në vendin tonë ambienti familjar nuk ka shumë ndikim në stilet e prindërimit pra ka edhe shumë faktorë të tjerë të cilët mund të jenë përcaktues të stileve të prindërimit.

Po të krahasohen rezultatet e këtij studimi me Studiuesit e fushës së edukimit të fëmijëve, shihet se janë bërë shumë kërkime për të parë funksionin në mes stileve të prindërimit dhe ambientit familjar.. Sidoqoftë, studimet e (Moriarty, 2007) fokusohen në teoritë më relevante të stileve të Prindërimit, supozojnë se një gamë e gjerë e relacionit të stileve të Prindërimit dhe ambientit familjar, mund të sqarohet prej atribuimit të faktorëve të të mësuarit përgjatë jetës.

Diskutime për hipotezën H3: është paraqitur pohimin mbi dallimet e planifikimit dhe mos planifikimit familjar në kontekst të ambientit familjar

Për të parë dallimet mbi planifikimin apo mos planifikimin familjar në kontekst të ambientit familjar kemi aplikuar analizën e t-testit, nga rezultatet e kësaj analize shohim se familjet e planifikuara arrin mesatare të ambientit familjar ($M=2.27$ dhe $Ds=0.19$) kurse familjet e pa planifikuara kanë mesatare të ambientit familjare ($M=2.31$ dhe $Ds= 0.23$) Signifikanca është 0.572. $p>0.05$ në nivelin e rëndësisë 0.05. Nga kjo mund të themi se ekzistojnë dallime të vogla ndërmjet familjeve të planifikuara dhe ato të pa planifikuara por nuk ka ndonjë rëndësi signifikante nga këto rezultate themi se nuk e pranojmë hipotezën 3.

Hulumtuesit kanë gjetur se planifikimi apo jo planifikimi, janë faktor shumë të rëndësishme në ambientin familjar (Lofquist & Dawis, 1969).Theksojmë se po të krahasohen gjetjet e këtij studimi me një studim të kryer në pesë zona të Hamburgut me 155 pjesëmarrës të familjeve të planifikuara dhe atyre të pa planifikuara të gjithë spektrit të gradave, moshës, dhe tek te dy gjinitë rezultoi së 19% e tyre kishin një ambient jo të mirë familjar kur familja e tyre nuk ishte planifikuar krahasuar me familjet e planifikuara ku vetëm 8% e tyre kishin një ambient jo të mirë familjar.

Diskutime për hipotezën H4:është paraqitur pohimin mbi dallimet e gjinore në kontekst të personalitetit të fëmijëve

Për të parë dallimet gjinore në kontekst të personalitetit të fëmijëve kemi aplikuar analizën e t-testit, nga rezultatet e kësaj analize shohim se femrat arrin mesatare ($M=2.48$ dhe $Ds=0.63$) kurse meshkujt kanë mesatare ($M=2.80$ dhe $Ds= 0.58$). Signifikanca është 0.51. $p>0.05$ në nivelin e rëndësisë 0.05. Nga kjo mund të themi se ekzistojnë dallime të vogla gjinore në kontekst të

personalitetit të fëmijëve por nuk ka ndonjë rëndësi signifikante nga këto rezultate themi se nuk e pranojmë hipotezën 4.

Një rezultat i tillë konfirmohet edhe në studimet e Hulin (1964), Rapti dhe Karaj (2012), dhe Zembylas dhe Papanastasiou (2004), Crossman dhe Harris (2006), por ka dhe të dhëna nga studimet e tjera që konfirmojnë të kundërtën që ka diferenca statistikore në kontekst të personalitetit të fëmijëve.

PËRFUNDIMET

Si përfundim të këtij studimi mund themi se çdo prindër dëshiron edukimin e mirë të fëmijëve, kështu që ata më vonë të jenë të mirë, të sigurt dhe të lumtur në jetë. Nga rezultatet e studimit tonë shihet ambienti familjar ka marrëdhënie lineare pozitive me personalitetin e fëmijëve por kjo lidhje nuk është signifikante, po ashtu rezultatet e studimit tregojnë se nuk ka dallime signifikante në mes ambientit familjar dhe stileve të prindërimit për të gjitha stilet e prindërimit, nga rezultatet e këtij studimi gjithashtu kemi ardhur në përfundim se familjet e planifikuara kanë ambient më të mirë familjar se sa familjet e pa planifikuara. Nga rezultatet gjithashtu vijmë në përfundim se nuk ka dallime të rëndësishme në shfaqjen e personalitetit tek fëmijët.

Nga të gjithë institucionet shoqërore më e rëndësishmja ka qenë, është dhe mbetet familja. Familja është ajo që edukon, kujdeset dhe rrit fëmijën, kështu që vendin dhe rolin e saj primar nuk mund ta zërë asnjë institucion tjetër. Ajo edhe në shoqëri është një burim i pashtershëm vlerash, pasi ndjenjat njerëzore në funksionimin e saj zënë vendin qendror. Për këto arsye, familja klasifikohet si një institucion shkatërrues nga Ferdinand Mount, ndërsa Platoni i jep asaj një vend të rëndësishëm krahas “shtetit” duke theksuar rëndësinë që ka. Në të njëjtën kohë familja është dhe mbetet transmetuesi i vlerave universale humane tek gjeneratat dhe mësuesi që harmonizon emocionet e njeriut me fuqinë morale

Familja edhe pse ka pësuar ndryshime të mëdha dhe rrënjësore, prapë mbetet rrethi i parë natyror i çdo edukimi, përgjegjësie për fëmijë dhe për rini. Mu për këtë familja s’mund të jetë indiferente, neutrale, t’i edukojë fëmijët vetëm për përshtatje ndaj jetës dhe punës, por duhet t’ua jep përvojë kujdesi, mirësie, butësie dhe dashurie, sepse është bartëse dhe edukuese për jetë dhe për vlera.

Nga rezultatet e studimit tonë mësuam se ambienti familjar ka marrëdhënie lineare pozitive me personalitetin e fëmijëve por që kjo lidhje nuk është signifikante, po ashtu ambienti familjar ka marrëdhënie lineare pozitive me stilet e prindërimit por as kjo lidhje nuk është signifikante në mes dy ndryshoreve. Edhe personaliteti i fëmijëve ka marrëdhënie lineare pozitive me stilet e prindërimit por lidhja e tyre nuk është signifikante. Nga rezultatet gjithashtu kuptojmë se familjet e planifikuara arrin mesatare të ambientit familjar më të ulët se sa familjet e pa planifikuara kanë mesatare të ambientit familjare.

Si përfundim mund të përmbledhim se çdo fëmijë lind në një ambient të quajtur familje, qoftë edhe nëse nuk rritet brenda saj, ai rrjedh nga ajo familje në të cilën ka lindur. Edhe në rastet kur nuk rritet me të apo pa të, në të dyja familja ka ndikim, sikur kur edukon ashtu edhe kur ajo mungon. Me sa shohim është tërësisht e pashmangshme ndikimi i faktorit familje dhe ambientit të saj në edukim. Edukimi i përkryer do të reduktohej në një fjali: Ofro vetëm dashuri, bëhu vetëm dashuri. Por në botën në të cilën jetojmë, fëmijët rriten të përballur me marrëdhënie të shumta që nuk mbështeten në dashuri, në radhë të parë jashtë familjes, por ndonjëherë edhe në familje (Chopra). Familja, me të drejtë konsiderohet si faktor i rëndësishëm i edukimit dhe formësimit të personalitetit. Cilësia dhe fuqia e ndikimit edukativ të familjes varet nga shkalla e pedagogjizimit të familjes, respektivisht, nga ajo se sa është familja “veprues i qëllimshëm dhe i organizuar edukativ (Rowe, 1994).

REKOMANDIME

1. Rekomandohet të realizohet ndërgjegjësim masiv i familjes, lidhur me ndikimin e ambientit familjar në formimin e personalitetit tek fëmijët. Ashtu si fushatat e ndryshme që realizohen për ndërgjegjësimin e qytetarëve lidhur me mbrojtjen e shëndetit, për sensibilizimin kundër drogës e duhanit, për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve jetim, apo të ngjashme me to, duhet të realizohet më shumë punë sensibilizuese nga organet kompetente, përfshirë këtu institucionet e përkujdesjes sociale në pushtetin qendror dhe vendor.
2. Duhet të realizohen fushatat sensibilizuese në nivel medial, nga organizatat jofitimprurëse, si dhe në shkolla, si institucione edukative, për të bërë të ditur pasojat që sjell mos ambientimi familjar i fëmijëve. Ky rekomandim vjen pasi vlerësohet se nuk bëhet punë e mjaftueshme për të kuptuar gjenezën e problemeve që paraqesin fëmijët në aspektin psikologjik dhe të sjelljes.
3. Duhet të rishikohet dhe rritet mbështetja socio-ekonomike e familjeve me një prind. Ky rekomandim vjen pasi vlerësohet se, në vendin tonë, pjesa më e madhe e konflikte devijojnë si pasojë e problemeve financiare, që shkaktohen nga prishja e ekuilibrave në familje. Rekomandohet që mbështetja e familjeve me një prind të realizohet në nivel legjislativ, administrativ, dhe të përkujdesjes së drejtpërdrejtë të specialistëve të shëndetit mendor, që janë në kontakt me këto familje.
4. Duhet të rritet vëmendja ndaj ambientimit të fëmijëve në familje nga shërbimi psikologjik në shkolla, pasi konstatohet se puna e psikologut shkollor është ende shumë e vakët lidhur me këtë grup fëmijësh.
5. Duhet të përmirësohet roli i psikologut ligjor, si specialist i fushës, i cili ka përballje të drejtpërdrejtë me formimin e personalitetit të fëmijëve. Vetë psikologu duhet të jetë i aftë të njohë dhe kuptojë psikologjinë e fëmijës, sipas stadi të zhvillimit të moshës.
6. Rekomandohen të standartizohen instrumente matëse, me qëllim matjen e ambientimit të tyre në familje si dhe formimit të personalitetit.
7. Rekomandohet të realizohen studime me kampion të gjerë për ndikimin e ambientit familjar në formimin e personalitetit të fëmijëve.

LITERATURA

Adler, A. (1978). *The Education of Children*. Washington: Regnery.

Bayle, F. (2005). The parenting. In I. Leal (Ed.), *Psychology of pregnancy and parenting* (pp. 317-346). Lisbon: Fim de Século.

Becker, G. (1964). *Human capital: a theoretical and empirical analysis, with special reference to education*. Chicago: University of Chicago Press.

Berry, J., Kagitcibasi, C., Georgas, J., Poortinga, Y., & Van de Vijver, F. (2006). *Families across cultures: A 30-nation psychological study*. Cambridge: Cambridge University Press.

Biduph, S. (1998). *The secret of happy children*. Australia: Harper Collins.

Bigner, J., & Gerhardt, C. (2014). *Parent- Child Relations, An introduction to parenting*. New Jersey: Pearson Education.

Boere, G. (2004). *Teoritë e personalitetit*. Tiranë: Plejad.

Brada, R. (1995). *Pedagogjia familjare*. Pejë.

Brada, R. (2012). *Edukimi mendor e moral i fëmijës*. Prishtinë: AAB Riinvest.

Buzan, T. (2007). *Truri i fëmijës, Prindër të zgjuar, që rrisin fëmijë të zgjuar*. Tiranë: Max.

Black, S. E., Devereux, P. J., & Salvanes, K. G. (2005). The more the merrier? The effect of family size and birth order on children's education. *The Quarterly Journal of Economics*, 669-700.

Cherry, K. (2011). *Parenting Styles. The four style of parenting*.

Chopra, D. (2009). *Si ti edukoni fëmijët*. Prishtinë: Titanik.

Deva-Zuma, A. (2003). *Edukimi i parashkollorit në familje*. Prishtinë: Libri Shkollor.

Deva-Zuna, A. (2008). *Dhuna në familje nën thirrjen pedagogjike*. Prishtinë: Libri Shkollor.

- Deva-Zuna, A., & Nimonaj, V. (2017). *Pedagogjizmi kjo polifoni edukative*. Prishtinë: Libri Shkollor.
- Dolito, F. (2001). *Etapat kryesore të fëmijërisë*. Tiranë: Toena.
- Dubow, E., Boxer, P., & Huesmann, L. (2009). *Long-term effects of parents' education on children's educational and occupational success*. London: Merrill-Plamer Quarterly.
- Freud, A. (2015). *Psikanaliza për fëmijë*. Tiranë: Fan Noli.
- Freud, S. (1958). *Psychoanalysis; Basic Writing*. Random House. New York.
- Freud, Z. (2003). *Pesë leksione mbi psikanalizën*. Tiranë: Fan Noli.
- Garuli, L. (2017). *Zbulo fëmijën tënd Interpretimi i vizatimeve të fëmijëve*. Tirnanë: Albanian University Press.
- Gjevori, M. (2005). *Prindërit- edukatorët e parë të fëmijëve*. Prishtinë: Rilindja.
- Gjika, L. (2018). *Fëmijëria*. Tiranë: Infbotues.
- Gross, S. (1993). *Early mathematics performance and achievement: results of a study within a large suburban school system*. *Journal of Negro Education*. London.
- Haliti, B. (2004). *Kultura dhe komunikimi familjar*. Prishtinë: Drita Press.
- Hoti, A. (2012). *Psikologjia e personalitetit, (koncepte, teori, elementë, metoda, trajnime)*. Tiranë.
- Jeffe, S., Moffit, E., Casipi, A., & Taylor, A. (2003). *Life with (or without) Father: The benefits of living with two biological parents depend on the father's antisocial behavior*. *Child Development*.

- Kalil, A., Ryan, R., & Corey, M. (2012). *Diverging destinies: Maternal education and the developmental gradient in time with children*. London: Demography.
- Kazmo, G., Thenasi, V., & Iliazi, Y. (2012). *Pedagogjia Familjare*. Tiranë: Natyra.
- Kraja, T. (2005). *Psikologjia e zhvillimit të fëmijës*. Tiranë: Progres.
- Kulkarni, S., Fareill, I., Erasi, M., & Koschar, M. (1998). *Empoëering parents to improve education*. London.
- Leal, I. (2005). New and old parenthoods. In I. Leal (Ed.), *Psychology of pregnancy and parenting* (pp. 363-409). Lisbon: End of the Century
- Lofquist, L. H., & Dawis, R. V. (1969). *Empowering parents to improve education*. New York.
- Macfarlane, M. (2004). *Family treatment of personality disorders- Advances in Clinical practice*. London: Taylor and Francis.
- Millon, T., & Melvin, L. (2003). *Personality and Social Psychology*. New Jersey.
- Montessori, M. (1972). *The secret of childhood*. New York: Ballantine.
- Montessori, M. (2009). *Zbulimi i fëmijës*. Tiranë: Plejad.
- Moriarty, J. (2007). *Family, ethnicity, and immigrant youths' educational achievements*. *Journal of Family Issues*. London.
- Moshman, D. (2005). *Rationality, Morality, and Identity*. London.
- Murphy, M., & Knudsen, L. B. (2002). The intergenerational transmission of fertility in contemporary Denmark: The effects of number of siblings (full and half), birth order, and whether male or female. *Population studies*, 56(3), 235-248
- Murphy, J., Vicent, N., Chopra, D., Scovel, F., & Field, L. (2012). *Si të keni martesë dhe familje të lumtur*. Prishtinë: Titanik.

- Nadaf, Z. (2017). *Education and personality development*.
- Ondag, F. (2018). *Prindërimi pozitiv në shekullin e internetit*. prizren: Pena.
- Pellai, A. (2013). *Mjaft më*. Tiranë: Ombra GVG.
- Rosenthal, M. (2004). *Be a Parent not a pushover*. London: Thomas Nelson.
- Rowe, D. (1994). *The limits of family influence – genes, experience, and behavior*. New York: The Guildorf Press.
- Samilaniq, V., & Toliçiç, I. (1976). *Psikologjia Fëmijënore*. Prishtinë: Riliindja.
- Sandahl, I., & Alexander, J. (2016). *The Danish Way of parenting*. New York: Teacher Perigee.
- Shaffer, D. (1979). *Social and personality development*. London: Cengage Learning.
- Sideris, N. (2010). *Fëmijët nuk duan psikolog. Duan prindër!* Tiranë: Nereida.
- Sulloeay, F. (1996). *Born to rebel: Birth order, familz dynamics, and creative lives*. New York: Penatheon Books.
- Templar, R. (2013). *The Rules of Parenting*. Edinburg Gate: Great Britain.
- Woolfolk, A. (2010). *Educational Psychology*. Tiranë: Centre Democatic Eduacation (CDE).

SHTOJCA

Pyetëtori 1

- Shkalla e arsimimit tuaj? *
- Arsimi bazë
- Arsimi i mesëm
- Arsimi Universitar

Martesa juaj është lidhur mbi bazën: *

- Dashurisë
- Ekonomike
- Shtytje familjare
- Parime jetësore të përbashkëta

Krijimi i familjes, lindja e fëmijës/ve ka qenë: *

- E planifikuar
- E paplanifikuar

Sa fëmijë keni? *

- 1
- 2
- 3
- më shumë se 3

Në cilin stil të prindërimit e shihni veten tuaj? *

- Prind me autoritet (shumë dashuri, shumë kontroll)
- Prind autoritar (pak dashuri, shumë kontroll)
- Prind tolerant (shumë dashuri, pak kontroll)
- Prind refuzues (pak dashuri, pak kontroll)

A keni një rregull familjar të cilin e ndiqni te gjithë? *

- Po
- Jo

Çka konsideroni primare për fëmijën tuaj?

- Ambientin që e rrethon
- Plotësimin e të gjitha kërkesave
- Edukimin dhe Lojën
- Dashurinë prindërore

Çfarë mendoni se ndikon më shumë në edukimin e drejtë të fëmijës tuaj: *

- Ambienti që e rrethon
- Mënyra si trajtohet në familje
- Afërsia me prindërit

- Edukimi dhe loja

Sa mendoni se ndikon raporti prindëror në formimin e personalitetit të fëmijës?

- Pak
- Mesatarisht
- Shumë

A pajtoheni se keni ndërtuar marrëdhënie bashkëpunuese me fëmijën tuaj?

- Pajtohem plotësisht
- Pajtohem pjesërisht
- Nuk pajtohem
- Nuk e di

A pajtoheni se raporti juaj si prind (pozitiv apo negativ) me fëmijën ndikon në formimin e tij si personalitet?

- Pajtohem
- Pajtohem pjesërisht
- Nuk pajtohem

A mendoni se kaloni kohë mjaftueshëm me fëmijën tuaj?

- Po
- Jo
- Nuk e di

A bisedoni me fëmijën tuaj për nevojat që mund të ketë dhe gjendjen e tij emocionale?

- Po, shpesh
- Ndonjëherë
- Asnjëherë

A mendoni se keni krijuar një marrëdhënie ku fëmija juaj shprehet lirshëm me ju?

- Po
- Jo
- Nuk e di

Sa ndikon raporti fëmijë prind për të krijuar një ambient të dëshirueshëm fmailjar?

- Shumë
- Mesatarisht
- Pak
- Nuk e di

Sa shpesh bëni diskutime familjare ku përfshihen edhe fëmijët tuaj?

- Shumë shpesh
- Mesatarisht
- Rrallë
- Asnjëherë

A e lejoni fëmijën tuaj të marrë ndonjë vendim që ndikon tek të gjithë anëtarët e tjerë? *

- Po
- Jo
- Varet

Sa pajtoheni se liria e shprehjes dhe dëgjimi i fjalës ndikon në formimin e vetëbesimit tek fëmija?

1 2 3 4 5

A respektoni privatësinë e fëmijës tuaj?

- Po
- JO
- Varet

A mund të ndikojnë prindërit në ndërtimin e raporteve mes fëmijëve?

- Po
- Jo

Si mendoni se ndikon favorizimi i njërit fëmijë karshi tjetrit?

- Prish marrëdhëniet ndërmjet tyre

- Shfaqje agresiviteti
- Humbje vetëbesimi
- Mbyllje në vetvete
- Të gjitha

A ka qenë ndonjëherë prezent fëmija juaj në zënkat tuaja si prindër?

- Po
- Jo

Nëse po, kjo ka qenë për arsye të: *

- Neglizhencës
- Për të përfituar anësinë e fëmijës
- E qëllimshme nga të dy prindërit
- E zakonshme në familje
- Fëmijët nuk kanë qenë prezent asnjëherë

A ndikon puna që bëni në raportin tuaj me fëmijën?

- Po
- Jo

Sa mendoni se keni krijuar një ambient të përshtatshëm në familje për fëmijën 1-5?

*

1 2 3 4 5

Çfarë e bën një familje që të ketë një ambient të mirë edukues?

- Shkalla e pedagogjizmit
- Aspekti ekonomik
- Rendi dhe rregulli në familje
- Stili i prindërimit

A mendoni se fëmija bëhet më social nëse ekspozohet në një rreth më të gjerë familjar?

- Po
- Jo
- Varet nga rrethi
- Nuk e di

Pyetëtori 2

Mosha juaj?

- 12-15
- 15-17
- 17-18

Si i shihni Prindërit tuaj?

- Prindër Autoritar (ata japin urdhra)
- Prindër tolerant (ata dorëzohen para jush)
- Prindër Demokratik (ju gjeni zgjidhje të përbashkëta)
- Prindër Neglizhent (ata nuk kane as dashuri as kontroll ndaj jush)

Si e shihni veten tuaj ne raport me familje? mund të zgjidhni më shumë se një opsion.

- Preferoni te jeni vetëm
- Kërkoni qetësi
- Jeni te vendosur dhe merrni përgjegjësi për gjerat tuaja
- Shijoni te jeni pjese e grupit familjar
- Mund t'i bindni të tjerët për gjërat që ju dëshironi t'i keni

Cili fëmijë jeni sipas renditjes?

- Fëmija i parë
- Fëmija i mesëm
- Fëmija i vogël

Si e shihni veten tuaj ne raport me Prindërit? Mund të zgjidhni më shumë se një opSION

- Prindërit më mbajnë nën kontroll gjatë gjithë kohës
- Më kuptojnë dhe mund të shprehem lirshëm me ta
- Ndjehem i/e frikësuar për gabimet e mia nëse ata e kuptojnë
- Ndjej mbështetjen e tyre në atë që më rrethon
- I përkëdhelur, ata duhet te më ofrojnë çdo gjë që unë kërkoj

Si e shihni veten tuaj ne raport me vëllezërit dhe motrat? Mund te zgjeshni më shumë se një opSION.

- Jam fëmijë i vetëm në familje
- Brengosem gjithnjë për të tjerët
- Ndihem më i padëshiruar se të tjerët
- Ndihem më i dëshiruar se të tjerët

- Kënaqem me praninë e tyre në familje

Sa ndikon gjendja ekonomike e familjes në raportin tuaj fëmijë- familje?

1 2 3 4 5 6 7 8 9 10

Si e shihni veten tuaj në raport me prindërit? Mund të zgjidhni më shumë se një opsion. Si e shihni veten tuaj në raport me vëllezërit dhe motrat?

1 2 3 4 5 6 7 8 9 10

Sa e konsideroni se familja juaj në bazë të të ardhurave ekonomike mund t'i përmbushin nevojat tuaja si fëmijë?

1 2 3 4 5 6 7 8 9 10